



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 462/1 Prot.

Tiranë, më 10.03.2025

V E N D I M

Nr. 54, Datë 10.03.2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 132, datë 14.06.2024, e znj. L.S, e përfaqësuar¹ nga Av. Th.Dh dhe Av. A.P kundër Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, në të cilën pretendohet për diskriminim për “*çdo shkak tjetër*”².

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe shtesë ankese të dërguar me datë 13.06.2024, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Ankuesja ka filluar punë si mjeke psikiatër pranë Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë në vitin 2007. Në vitin 2018 është emëruar Shefe e Shërbimit Kronik për Burra dhe Gra. Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë është një institucion që shpesh gjeneron probleme për shkak të punonjësve të saj dhe që kur znj. L.S është proceduar padrejtësisht (2015) për një veprim që është shpallur e pafajshme është kujdesur të

¹ Referuar Prokurës së Posaçme, nr. repertori 237, nr. koleksioni 86, datë 03.03.2022, të noteres B. L. H.

Referuar Prokurës së Posaçme nr. repertori 1051, nr. koleksioni 571, datë 28.03.2024 të Noteres V. S. M.

² “Pakënaqësia e drejtores rreth ankesave të znj. L.S, po ashtu fakti që nuk firmosi dokumentin në lidhje me tenderin për arredimin e ambienteve si dhe fakti që më pas ajo kishte ndërmarrë veprime për të dokumentuar punimet jo cilësore që janë bërë në spital”.

³ Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD.

jetë shumë e kujdesshme në punën e saj dhe sidomos kur gjatë ushtrimit të profesionit të saj, do duhet të ndërveproj me punonjësit e tjerë (qoftë ai mjekësor, infermierë, apo drejtues).

Vitin e kaluar janë përdorur materialet (ankesat) e znj. L.S në lidhje me parregullsitë e Spitalit Psikiatrik Vlorë në emisionin investigativ “Piranja⁴”, nga ku rezultoi edhe me largimin e ish-drejtoreshës (O.G).

Tani drejtore pranë Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë është znj. M.M, e emëruar me datë 03.11.2023, dhe duke qenë ende shefe e shërbimit kronik i referonte çdo shkelje, parregullsi apo mungesa që mund të kishte institucioni drejtoreshës, që të ishte e rregullt nga ana e saj. Si të tilla kemi bashkëngjitur disa nga parregullsitë që znj. L.S i vinte në dukje drejtores së institucionit.

Në kuadër të Urdhrit nr. 221, datë 20.11.2023, drejtoresha ka krijuar një komision për arredimin e ambienteve të shtëpizave të mbrojtura me 7 anëtarë dhe znj. L.S kryetare. Pasi znj. L.S i ka paraqitur drejtores projektin për arredimin, drejtoresha i ka kërkuar në datë 10.01.2024, që ajo të firmoste një dokument në kuadër të tenderit për arredimin e ambienteve. Gjë që nuk e bëri.

Në datë 09.01.2024, thirret mbledhje urgjente e Këshillit Tekniko Administrativ për të analizuar një incident të rëndë të ndodhur në pavijonin kronik gra, me pasojë djegien e këmbës në gradën e tretë të një pacienteje. Për arsye se konkluzionet nga kjo mbledhje ishin të paqarta për të identifikuar përgjegjësit, znj. L.S ka zhvilluar një takim me personelin e këtij pavijoni nga ku ka konkluduar për punonjësit përgjegjës, dhe ja ka bërë me dije drejtores së këtij institucioni. Ndërkohë që znj. L.S i ka bërë me dije drejtores për personat përgjegjës, nga ana e saj drejtoresha ka proceduar me vërejtje (me paralajmërim për largim nga puna) ndaj të gjithë punonjësve të ditës së incidentit të turnit 1, 2 dhe 3.

Duke qenë se drejtoresha nuk mund të përdorte këto shkaqe për ta larguar nga puna është kapur nga gjykimi profesional i mjekes, nëpërmjet relacioneve dhe procesverbaleve të mjekëve të tjerë sikur znj. L.S kishte bërë shkelje profesionale mjekësore.

Përveç faktit që drejtoresha nuk i ka kompetencat e gjykimit disiplinor profesional të mjekëve, ajo e ka diskriminuar atë nëpërmjet masës disiplinore edhe për faktin që pranoj për observim dhe mjekim pacientin S.L, diagnostikuar me post dehje alkolike dhe me çrregullim të sjelljes, ndërkohë që mjekët e tjerë që kanë vepruar po ashtu me rastet analoge të tyre (në ankesë ky veprim nuk është i ndaluar apriori, referuar shkresës së MSHMS, për udhëzimin që jep).

Ndërsa në plan të parë ky fakt duket si diskriminim, nuk e kemi adresuar si të tillë pranë jush, por e kemi kundërshtuar në gjykatë, për të qenë në dijeni drejtuesja e institucionit, dhe ndërsa u njoh me kërkesë padinë tonë përse i përket faktit që nuk është autoriteti kompetent për të gjykuar profesionalisht mjeken, ka vijuar me marrjen e masave të paligjshme. Në datë 30.05.2024, znj. L.S

⁴ <https://www.syri.net/politike/>
<https://www.youtube.com/watch?>

me shkresën nr. 1268, është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës bazuar në nenin 11 të Kontratës Individuale të Punës. Në qendër të kësaj shkrese për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës drejtoresha e Spitalit dyshojmë se referon 3 raste për shkelje profesionale të znj. L.S.

Dyshojmë se një nga këto 3 shkelje është sepse znj. L.S ka pranuar në datë 27.02.2024 për observim dhe mjekim një pacient që e diagnostikoi me post dehje alkolike dhe me çrregullim të sjelljes. Ndërkohë që edhe kolegë të saj kanë pranuar raste analoge, p.sh sipas librit të observacionit, znj. N.V pranon person të diagnostikuar me dehje alkolike me datë 15.01.2024 dhe del me datë 22.01.2024, znj. B.Ç pranon pacientin me çrregullim të sjelljes, nën ndikimin e abuzimit me alkolin, datë 11.02.2024, znj. E.T pranon pacient të diagnostikuar me dehje alkolike dhe çrregullim të sjelljes datë 03.03.2024, znj. E.Sh pranon pacient përdorues i alkolit dhe kanabisit, si dhe rasti i znj. L.S me datë 27.02.2024. Për këtë shkelje znj. L.S i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”.

Shkelja e dytë dyshojmë se lidhet me datën 27.05.2024, ku është marrë masë tjetër disiplinore “Vërejtje” ndaj znj. L.S për largim nga puna dhe shkelje të etikës profesionale. Spitali Psikiatrik i referohet faktit që, ndërsa znj. L.S ishte roje 24-orësh atë ditë, ka lënë pa mbuluar këtë shërbim për dy orë, ndërkohë që fakti se do mungonte njëri nga të gjithë mjekët të cilët kanë firmosur në kartelën e kësaj paciente (M.Sh), pasi në datë 22.04.2024 nga konsulta e përgjithshme mjekët konkluduan lindjen e parakohshme nën asistencën e gjinekologut dhe psikiatrit, më pas në datë 14.05.2024, konsulta gjinekologjike vendosi datën 24.05.2024, si datë lindje të pacientes (M.Sh), fakt përveçse është pasqyruar në kartelën e pacientes, i është bërë me dije edhe Shefes së Shërbimit Akut dhe Kronik nga znj. L.S.

Ndërsa shkelja e tretë dyshojmë se lidhet me datën 27.05.2024, ku znj. L.S duke shkuar në pavijon për të konkluduar mbi procedurën e shtrimit të pacientit R.V, ka konstatuar se ky pacient ankohej për duart e tij të cilat i kruheshin, ishin të skuqura dhe me edemë, për këtë gjë ka shkuar për të parë edhe pacientin tjetër që ishte në një dhomë me të, z. Sh.H, i cili kishte po ashtu simptoma të ngjashme. Dhe në këtë rast për shkak të shqetësimit të saj për mundësinë e një infeksioni parazitoz (ngjitës) ka kërkuar urgjent vizitë dermatologu pranë Poliklinikës Vlorë. Pasi mbaroi kontrolli i këtyre dy pacientëve shtetasi R.V ka sulmuar shoferin e ambulancës së Spitalit Psikiatrik (S.D) dhe më pas është larguar. Për këtë fakt është njoftuar Policia e Shtetit e cila pasi e kapi, e solli përsëri në Spitalin Psikiatrik Vlorë. Znj. L.S duke patur parasysh faktin që pacienti R.V ka qenë i qetë gjatë gjithë kësaj kohe ka pyetur këtë të fundit në lidhje me arsyen që e shtynë të sulmojë shoferin e ambulancës. Këtë dëshmi të pacientit znj. L.S e ka incizuar me telefon dhe e ka pasqyruar në kartelën e pacientit. Në këtë incizim pacienti thotë që është provokuar nga kujdestari (E.M), ndërsa shoferi (S.D) i ka thënë se: “bënë gango”. Në lidhje me këtë veprim të pacientit R.V, znj. L.S është qortuar përsëri dhe dyshojmë se, nga drejtoresha ky fakt është përdorur gjithashtu për të justifikuar Urdhrin nr. 188, datë 30.05.2024, për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës së znj. L.S.

Gjatë kësaj kohe (24.05.2024) znj. L.S kishte kryer edhe filmimet në lidhje me pavijonin 4-5 ku ishin futur pacientët në këtë ambient të pakolauduar.

Konsiderojmë që diskriminimi ka ndodhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës duke u bazuar në shkëljet disiplinore që i ka dhënë drejtoresha e institucionit, znj. L.S, të një pas njëshme (pra në një kohë shumë të shkurtër) dhe të padrejta për shkak të pakënaqësisë që znj. L.S kishte krijuar për shkak se ndërjegjja e saj nuk ja lejon të injorojë parregullsitë pranë këtij institucioni pa i vënë ato në dukje, qëndrime këto që kanë krijuar pakënaqësi. Dhe për shkak të këtyre pakënaqësive drejtoresha ka marrë masat disiplinore ndaj mjekes që kanë të bëjnë me vlerësime profesionale mjekësore, duke përdorur procesverbalet dhe relacionet e mjekëve, të cilët nuk janë organ i urdhrit të mjekut për ta gjykuar. Dhe për këtë fakt drejtoresha është në dijeni sepse kemi kundërshtuar masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, në gjykatë dhe ka bërë edhe prapësimet për këtë gjykim. Pra, edhe pse drejtoresha e di që as mjekët pranë Spitalit Psikiatrik Vlorë, as drejtoresha nuk janë kompetentë për ta gjykuar atë profesionalisht kanë proceduar përsëri me gjykim ndaj saj dhe me ndërprerjen përfundimisht të marrëdhënieve të punës, çka tregon pakënaqësinë që ka drejtoresha e institucionit ndaj znj. L.S, e cila nuk justifikohet që të ketë të bëjë me punën e saj (sepse drejtoresha e di që nuk është ajo kompetente për ta gjykuar), por që kanë të bëjnë me faktin që znj. L.S reagon në lidhje me gjërat që nuk shkojnë mirë në atë institucion.

Për sa më sipër, dyshojmë se në marrjen e masave disiplinore ndaj znj. L.S, kanë kontribuar pakënaqësia e drejtores rreth ankesave të znj. L.S, po ashtu fakti që nuk firmosi dokumentin në lidhje me tenderin për arredimin e ambienteve si dhe fakti që më pas ajo kishte ndërmarrë veprime për të dokumentuar punimet jo cilësore që janë bërë pranë këtij spitali. Për shkak të këtyre veprime të znj. L.S konsiderojmë që ajo është diskriminuar”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe kthimin në vendin e mëparshëm të punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar⁵, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të

⁵ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 894/2, datë 20.06.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Spitali Psikiatrik Vlorë, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Kopje të dosjes personale të ankueses (vendim emërimi, kontratë pune, masa disiplinore, vlerësim performance për vitet 2022 dhe 2023, etj).
 - Kopje të plotë të procedurës së ndjekur lidhur me dhënien e masave disiplinore *“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”* dhe *“Vërejtje”* për ankuesen.
 - Kopje të plotë të procedurës së ndjekur lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesen.
 - Informacion nëse Spitali i është drejtuar Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë për rastin e ankueses. Nëse po, kopje të shkresës dhe përgjigjes së dhënë.
 - Kopje të shkresave për shkelje/parregullsi/mungesa (relacion, kërkesë, procesverbal) të bëra nga ankuesja dhe përgjigjeve të dhëna nga institucioni.
 - Kopje të Urdhrit për ngritjen e Komisionit për pajisjen e shtëpizave dhe dokumentit që nuk ka pranuar të firmosë ankuesja, në kuadër të prokurimit për arredimin e shtëpizave.
 - Informacion dhe kopje të dokumentacionit për rastet e referuara nga ankuesja lidhur me pranimin e pacientëve me diagnozë dehje alkolike (për mjekët: znj. N.V, znj. B.Ç, znj. E.T dhe znj. E.Sh).
 - Informacion të plotë, nëse ka pasur mjekë të tjerë (në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesen) për të cilët është dhënë masë disiplinore, për periudhën 01.01.2021 deri më 06.03.2024. Nëse po, kopje të procedurës së ndjekur.

- Kopje të dokumentit në të cilën parashikohen procedurat, detyrat dhe kompetencat e Këshillit Tekniko Administrativ të Spitalit dhe gjetjet e këtij komisioni të mbledhjes së datës 09.01.2024.
- Kopje të protokollit mjekësor të diagnostifikimit dhe mjekimit në Shërbimin e Shëndetit Mendor.
- Kopje të emërimit të Drejtores Znj. M.M.
- Kopje të Rregullores së Brendshme dhe Kodit të Etikës të Spitalit Psikiatrik Vlorë.
- Informacion nëse kjo çështje po ndiqet gjyqësisht. Nëse po, kopje të kërkesë padisë dhe parashtrimeve të Spitalit Psikiatrik Vlorë.

Me shkresën me nr. 1471/1, datë 02.07.2024, Spitali Psikiatrik Vlorë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Në lidhje me ankesën e paraqitur prej znj. L.S duam të theksojmë se pretendimet e saj janë të pa bazuara, pasi në asnjë rast prej vendimeve të marra nuk ka pasë elementë të diskriminimit. Masat e marra nga drejtoria kundrejt saj kanë qenë si rrjedhojë e problematikave të krijuara nga ana e saj në institucion, lidhur me zbatimin e protokolleve të mjekimeve, shkeljes së etikës profesionale dhe asaj të komunikimit dhe sjelljes në një administratë shtetërore.*

Duam t’ju bëjmë me dije se mjekja në fjalë gjatë gjithë viteve të punës në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, në mënyrë të herëpashershme ka marrë masa disiplinore si, tërheqje vëmendje, vërejtje, pezullime nga të gjithë drejtuesit e mëparshëm me të cilët ajo ka qenë e punësuar dhe ka krijuar konflikte të vazhdueshme nisur që me eprorë, kolegë, staf mjekësor dhe staf psiko-social.

a. Në lidhje me pacientin S.L ka shkelur protokollet e mjekimit duke trajtuar me raki një pacient në Spitalin Psikiatrik dhe paradoksalisht ka rrezikuar jetën e këtij të fundit. Znj. L.S ka ushtruar presion psikologjik mbi k/infermierin e urgjencës E.H duke e detyruar atë dhe të tre turnet e tjerë t’i jepnin raki në fshehtësi. Theksojmë se shishja e rakisë mbahej në dollapin e medikamenteve. Ishte k/infermieri i pavijonit E.H i cili ditën e nesërme e paraqiti si problematikë para shefes së shërbimit dhe mjekëve të tjerë (Dr. B.C, Dr. N.V, Dr. E.T) i cili ishte shumë i tensionuar në emër të stafit që po viheshin nën presion psikologjik nga kjo mjekje për ti dhënë alkool të sëmurit gjatë vakteve.

Gjithashtu ka përdorur manitol me përshkrim të neurologut që përdoret në pavijonet neurologjike edhe pse në konsultën nga neurologu të pasqyruar në kartelën klinike të pacientit figuron pa probleme neurologjike dhe nuk i ka rekomanduar terapi. Duke konkluduar në diagnozën “abstinencë nga alkoli”. Ajo që duam të theksojmë është se problemi nuk qëndron pse është pranuar një pacient përdorues i alkolit në spitalin psikiatrik, por trajtimi që i është bërë nga doktoresha është jashtë protokolleve dhe diagnostikimit të mjekimeve me medikamente të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë në një urgjencë psikiatrie, duke rrezikuar edhe jetën e vetë pacientit. Kjo përbën edhe një ndryshim të madh të këtij rasti me rastet e tjera analoge të trajtuara nga doktoreshat e tjera, e përmendur kjo në ankesën e znj. L.S.

Doktoresha për rastin e pacientit S.L është thirrur fillimisht nga Shefja e Shërbimit Akut dhe Nën/Dr Teknik për të sqaruar situatën dhe arsyen pse kishte përdorur raki te pacienti, ku znj. L.S

është përgjigjur me prepotencë dhe arrogancë (bëni çfarë të doni, shkoni ku të doni, nuk dua t'ia di fare) dhe në mënyrë demonstrative është larguar nga dhoma e konsultës.

Pra a ka diskriminim këtu?! apo ka shkelje shumë të rënda nga kjo mjeke?! Po ashtu për këtë rast është thirrur dy herë dhe nga drejtoria e institucionit për të bërë mbledhje, por nuk është paraqitur, me pretendime të pajustificueshme. Për sa më sipër mjekët e spitalit i janë drejtuar Avokatit të Popullit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Urdhrit të Mjekut.

Para se të thirrej nga këta të dy, shefja e shërbimit e pyeti pse përdore këtë terapi dhe nuk më ke informuar, mjekja ka mbajtur një qëndrim arrogant dhe prepotent duke thënë se unë “bëj shkencë” dhe ju nuk më kuptoni dhe ka shkelur etikën duke përdorur fjalor jo të përshtatshëm për administratën publike (fjalor banal).

Duke marrë shkas nga regjistri i observacionit të institucionit me nr. 48, datë 09.01.2024, por dhe rasteve të përmendura në ankesën e znj. L.S, rezulton se në datën 15.01.2024, mjeke roje ka qenë B.C dhe jo daktroreshë N.V, i vetmi rast observacioni është mbajtur personi me inicialet G.H, banues në Gjirokastër me diagnozë “Çrregullim të sjelljes në person me çrregullim prevaziv të zhvillimit”.

Në datën 11.02.2024 rezulton mjeke roje E.T dhe jo mjeke B.C, mbahet në observacion personi me inicialet R.B nga Vlora me diagnozë “Çrregullim sjellje me etilizëm kronik”.

Në datën 03.03.2024 rezulton mjeke roje E.Sh dhe jo E.T ashtu si referohet në ankesën e znj. L.S dhe në bazë të librit të observacionit paraqitet pacienti me inicialet K.H me diagnoze “Abuzim alkoli dhe kanabisi”.

Ju bëjmë me dije se;

Të gjitha rasteve të përmendura më sipër ju është ofruar ndihmë nga mjekët roje konform protokolleve mjekësore dhe asnjë nga këta mjekë nuk ka përdorur si (formë trajtimi rakinë).

Përsa i përket rastit me pasojë djegien e këmbës së pacientes, znj. L.S ka shpifur, pasi rasti në fjalë është referuar nga mjeke E.Sh sepse mjeke Znj. L.S ka qenë me leje. Gjithashtu nuk rezulton se pas mbledhjes me personelin e pavijonit kronik-gra, znj. L.S të ketë paraqitur pranë drejtorisë ndonjë rezultat të mbledhjes së bërë ku të komunikoheshin personat përgjegjës të incidentit të ndodhur.

b. Gjithashtu etika dhe profesionalizmi është shkelur edhe në rastet kur është lënë shërbimi pa mbuluar kur ka qenë mjeke roje, konkretisht në rastin e pacientes M.Sh, pra rasti i datës 27.05.2024, kjo mjeke ka qenë në shërbim 24 orë dhe është paraqitur në spital rreth orës 12:00, ku e prisnin në spital shumë pacientë, urgjenca dhe konsulta dhe znj. L.S nuk lajmëroi asnjë mjek ose epror për ta zëvendësuar. Nuk janë 2 orë, por rreth 4 orë që mungonte, pasi shërbimi merret në orën 08:00 dhe nuk ka qenë as në Spitalin Rajonal. Më pas infermieres që e shoqëronte (E.T) pacienten i ka bërë presion në telefon që ti do të thuash që unë kam qenë gjatë gjithë kohës në

Spitalin Rajonal, por ajo qëndroi atje vetëm 5 min. Në orën 08:00 kjo paciente është shoqëruar për në Spitalin Rajonal vetëm nga infermierja e sipër përmendur dhe jo nga mjekja.

c. Theksojmë se për sa i përket rastit të pacientit R.V, ku pacienti ka qenë shumë i rrezikshëm është paraqitur në spital me thikë dhe përbënte rrezikshmëri për komunitetin. Në këto kushte, prania e urtikarieve përballë rrezikshmërisë së pacientit, duhej të merrej parasysh kjo e fundit, dhe konsulta me specialistin mund të ishte bërë On Call ose të thirrej specialisti në spitalin tonë. Përsa i përket incizimit që i është bërë pacientit nga znj. L.S është një shkelje shumë e rëndë e të drejtave të njeriut (mbështetur në ligjin nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”) duke ushtruar presion e shantazhe ndaj të sëmurit që të merrte deponime që i interesonin znj. L.S për interesa vetjake. Vetë mjekja e ka shkruar në kartelë që pacienti përbën rrezikshmëri dhe për këtë arsye nuk duhet të kishte dalë fare nga spitali (duke rrezikuar stafin). Në një konsultë me shefen e shërbimit ka kërkuar vetë znj. L.S që të transferohet urgjent në institucionet e sigurisë së lartë. (bashkëlidhur procesverbalet e stafit për incidentin).

Në lidhje me etikën dhe komunikimin e saj ka krijuar problematika me të gjithë eprorët, kolegë, staf mjekësor, staf psiko-social, madje dhe me punonjësit e administratës. Ka arritur deri aty sa ka përdorur fjalor banal, denigrues, ofendime shumë të ulëta deri në familjet e tyre. (për të gjitha këto do tju vendosim në dispozicion dokumentet përkatëse)

Në lidhje me pretendimin se është detyruar të firmosë për tenderin me mobilimin, ky pretendim nuk qëndron aspak, pasi në kohën që ishte duke u përgatitë procedura, ish shefja e shërbimit kronik ka qenë në grupin e punës për të përcaktuar specifikimet e mobilimit që lidhen me pacientin psikiatrik, në asnjë moment nuk ka pasur kundërshtime verbale dhe shkresore nga znj. L.S si kryetare e komisionit, po ashtu as nga anëtarët e tjerë. Përbërja e këtij komisioni përfshinte ekipin multidisiplinar që ofronte shërbimin në pavijonin kronik.

Në lidhje me komunikimet me nën/dr teknik, komunikimet verbale dhe shkresore nga ana e znj. L.S ashtu si dhe paraqitet në ankesë, nuk kanë qenë korrekte duke përdorur mjete komunikimi dhe regjistrimi, duke qenë të paligjshme në ambientet e institucioneve shtetërore. Kjo praktikë e ndjekur lidhet edhe me metodologjinë e punës së ndjekur edhe më përpara duke ushtruar presion jo vetëm te personeli shëndetësor por edhe në administratë.

Fakte këto që vërtetojnë se jo vetëm që nuk ka patur frymë bashkëpunimi me stafin por edhe ka krijuar problematika duke ju rrezikuar jetën (procesverbalet e shoferit dhe kujdestarit). Nga ana e drejtorisë është thirrur edhe pa protokoll, për të rritur frymën e bashkëpunimit dhe komunikimit sa më të përshtatshëm, gjë e cila nuk është reflektuar në vazhdimësi.

Në mbledhjen e realizuar me drejtuesin e DROSHKSH, në datën 30.04.2024, për problematikën e shfaqura nga ana e mjekes në raport me kolegët, gjuha e përdorur ka eskaluar edhe në fyerje ndaj kolegëve, gjë e cila verifikohet edhe nga proces verbalet e mbajtura në institucion. Për gjithë ecurinë, drejtori i DROSHKSH ka qenë në dijeni.

Situatat e njëpasnjëshme që kanë sjellë vështirësi në përmbushjen e detyrës dhe jo vetëm të mjekes por të të gjithë stafit, i cili ndihej i kërcënuar nga veprimet dhe mosveprimet e mjekes, nëse nuk do të merreshin masa të menjëhershme do të kishim të bënim me diskriminim masiv kundrejt stafit dhe favorizim të znj. L.S”.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, përfaqësuesi i ankueses nëpërmjet e-mail-it datë 05.07.2024, është njohur me përgjigjen e Spitalit Psikiatrik Vlorë.

Përfaqësuesit e ankueses me shkresat datë 18.07.2024 dhe 20.07.2024, kanë dërguar kundërshimet e tyre, duke informuar si më poshtë:

- 1. “Pasi u njohëm me përgjigjen e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, dëshirojmë që para se të kalojmë në trajtimin e rasti tonë të diskriminimit të cilin dëshirojmë ta plotësojmë me fakte dhe argumente rreth arsyeve të cilat kanë shtyrë punëdhënësin të marri veprimet e paligjshme duke e diskriminuar, po ju parashtrojmë të pavërtetat e drejtoreshës nëpërmjet të cilave përpiqet të prezantohet tashmë, sikur veprimet e tyre nuk kanë qenë tendencioze, të paligjshme dhe diskriminuese.*
- 2. Në paragrafin e parë dhe të dytë të pikës 1, drejtoresha referon se ndaj mjekes janë marrë masat për arsye se është problematike, duke përdorur si provë në lidhje me sjelljen problematike të znj. L.S masat e marra në të kaluarën ndaj saj. Masat që janë marrë konsiderohen të shuara ndërsa pezullimi që i referohet, në bazë të shkresës nr. 2895, datë 04.06.2013, të Ministrit, z. H.K kishte vendosur gjithashtu rikthimin e znj. L.S.*
- 3. Nga njëra anë znj. L.S i japin vlerësimet maksimale (referuar formularit të vlerësimit) për periudhën Korrik-Dhjetor 2023, nga ana tjetër drejtoresha përpiqet ta prezantoj si problematike dhe manipulatore.*
- 4. Në trajtimin e pacientit S.L, ndërsa në relacionet dhe procesverbalet që janë mbajtur në lidhje me këtë pacient këto thënie janë referuar nga mjekët që nuk kanë qenë prezent, ditën që ka pranuar pacientin dhe e ka mjekuar, në përgjigjen e tyre drejtuar jush paraqesin K/Infermierin E.H sikur i ka thënë, ndërkohë që këtij të fundit nuk i është kërkuar kurrësi të nënshkruaj në ndonjë procesverbal apo relacion rreth atyre që dinte. Madje, duke ditur që këto që referojnë janë të pavërteta nuk e dimë edhe nëse z. E.H realisht di që përdoret emri i tij në këtë kthim përgjigje sikur ka thënë që kanë ndodhur këto gjëra.*
- 5. Në paragrafin e dytë të faqes së dytë drejtoresha thotë që: “problemi nuk qëndron pse është pranuar një pacient përdorues i alkolit në spitalin psikiatrik, por trajtimi që i është bërë nga doktoresha”, ndërkohë, në procesverbalin nr. 632, datë 05.03.2024 në lidhje me rastin ku drejtoresha kërkonte mendimin e mjekëve në lidhje me masat që duhet të merren, “nga Nd/Teknik thuhet se një nga shkëljet ka qenë pranimi në Spital i pacientit të alkoolizuar”, gjithashtu dhe në relacionin nr. 596, datë 01.03.2024, thuhet se: “.. nga ana e Dr. L.S janë kryer shkëljet si më poshtë... 1. Është pranuar një person alkolist i cili kur u paraqit në spital ishte i dehur (kishte konsumuar 2 litra raki) pa asnjë kriter mjekësor psikiatrik duke rrezikuar jetën e pacientit, ky i fundit i pranuar në kushtet e intoksikacionit”, edhe në ankesën drejtuar Urdhrit të*

Mjekut me datë 29.04.2024 në pikën 2 thuhet: “Doktoresha e ka bërë pranimin e pacientit të alkolizuar, duke shkelur Urdhrin e MSH...”.

- 6. Në paragrafin e dytë të faqes së dytë ngrihen pretendime sikur znj. L.S nuk i ka folur mirë Shefes së Shërbimit Akut ndërkohë që shefja e kishte poshtëruar me pyetjet përçmuese që i bënte përpara pacientit rreth mënyrës që kishte vepruar me mjekimin e pacientit. Ndërkohë që, në kuadër të përgjegjësisë personale që ka çdo mjek duhet të respektohet edhe liria dhe pavarësia profesionale e tij. (neni 10 § 12 i Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore)*
- 7. Po aty thuhet gjithashtu se është mbajtur edhe mbledhja për këtë qëllim dhe që znj. L.S ka munguar me pretendime të pajustificueshme. Ndërkohë që, tematika e mbledhjes së datës 01.03.2024 nuk dihej paraprakisht, dhe fakti që znj. L.S do mungonte atë ditë me leje dihej pasi, Nd/Teknik kishte njoftuar në komunikimin në grup që kanë mjekët se mbledhja do anulohet sepse znj. L.S nuk do ishte. Ndërsa, në datë 05.03.2024 znj. L.S është larguar nga institucioni pak më herët nga orari zyrtar sepse kishte përfunduar shërbimin 24-orësh si roje, dhe gjatë ditës që është njoftuar për mbledhjen, u tha se, përveçse ishte larguar se kish qenë roje, gjithashtu e kishin njoftuar edhe nga shkolla që vajza e saj kishte dhimbje të barkut, duke shkuar kështu për ta marrë, për ta vizituar. Ndërkohë në të dyja rastet mbledhja është zhvilluar normalisht.*
- 8. Në lidhje me paragrafin e tretë të faqes dy, nuk është e vërtet që znj. L.S kishte këtë qëndrim. Po ashtu rastet që kemi referuar nga libri i observacionit nuk janë ashtu siç i prezanton drejtoresha.*
- 9. Në lidhje me paragrafin e parë të faqes së tretë, është e vërtet që znj. L.S ka qenë me leje, por asaj i është kërkuar që të ishte prezent në mbledhjen e datës 09.01.2024 të Këshillit Teknik Administrativ. Nuk e dimë në këtë rast nëse ardhja e znj. L.S është kërkuar për shkak të incidentit që duhej mbajtur mbledhja apo për shkak se drejtoresha donte ti kërkonte në datë 10.01.2024 znj. L.S, të firmoste një dokument në lidhje me arredimin e shtëpive të mbrojtura.*
- 10. Në rastin e pacientes M.Sh në datë 27.05.2024 (me shkresën nr. 1233) Drejtoresha e Spitalit Psikiatrik merr masën disiplinore “Vërejtje” ndaj saj. Kjo masë disiplinore i është dhënë znj. L.S për arsye se në datë 24.05.2024 që ishte roje 24-orësh pranë Spitali Psikiatrik ka lënë shërbimin për 3 orë në mëngjes për të asistuar një paciente psikiatrie për të lindur në Spitalin Rajonal Vlorë.*
- 11. Kjo datë lindje e pacientes M.Sh është përcaktuar që në datë 14.05.2024 nga mjekët obstetërgjinekolog të Spitalit Rajonal Vlorë dhe është pasqyruar në kartelën e pacientes pranë Spitalit Psikiatrik Vlorë.*
- 12. Drejtoresha e Spitalit Psikiatrik në vend që të marrë masat ndaj Shefit përgjegjës që nuk kishte koordinuar punët në institucion, duke qenë se duhet të dinte kush ishte roje atë ditë dhe kush ishte planifikuar të shoqëronte pacienten M.Sh për të lindur, morri masën disiplinore ndaj znj. L.S që ishte planifikuar të shoqëronte pacienten për të lindur. Gjithashtu fakti që ka munguar 4 orë dhe sikur znj. L.S i ka bërë presion infermieres E.T nuk është i vërtetë.*
- 13. Po ashtu nga ana e drejtoreshës është pretenduar se znj. L.S ka nënvlerësuar rrezikshmërinë e pacientit R.V i cili sulmoi shoferin dhe kujdestarin në datë 27.05.2024, kur znj. L.S konsideroi rast urgjent kontrollin e tij dermatologjik pranë Poliklinikës Vlorë. Ndërkohë që pacienti i znj. L.S ishte shumë i qetë kur vajti në Poliklinikë, acarimi i tij siç rezulton edhe nga procesverbali i mbajtur ka ndodhur kur ka dalë nga Poliklinika duke vajtur në drejtim të ambulancës. Incizimi*

në rastin konkret i thënieteve të pacientit R.V nuk përbën një shkelje shumë të rëndë por përbën vlerësim të fakteve për evidentimin e së vërtetës në kuadër të identifikimit të përgjegjësve real dhe jo të përgjegjësve që u interesojnë. Ndërsa ky veprim duhej vlerësuar nga drejtoresha, drejtoresha ka parë si të manipuloj të vërtetën sikur znj. L.S ka ushtruar presion dhe shantazh ndaj pacientit për të marrë deponimin dhe që i ka shkelur të drejtat e njeriut.

II. Në lidhje me shkakun diskriminues ndaj znj. L.S:

- 14. Para se të merreshin masat disiplinore dhe masa për ndërprerjen e marrëdhënieteve të punës, znj. L.S nuk druhej për t'i vënë në dukje problematikat e këtij Spitali dhe konkretisht.*
- 15. Znj. M.M është emëruar Drejtoresh e Spitalit Psikiatrisë Vlorë në datë 03.11.2023. Me Urdhër nr. 221, datë 20.11.2023, kjo e fundit ka vendosur ngritjen e Komisionit për arredimin e shtëpizave të mbrojtura me shtatë anëtare dhe kryetare znj. L.S. Brenda afatit ligjor kanë dhënë idenë se si duheshin arretuar dhomat sipas funksionalitetit të pacientëve. Në datë 10.01.2024 znj. M.M ka kontaktuar znj. L.S dhe i ka kërkuar të nënshkruaj, në cilësinë e kryetares së Komisionit të caktuar me urdhrin e sipërcituar, një dokument në të cilin ishin listuar pajisjet dhe orenditë e shtëpizave të mbrojtura si edhe çmimet përkatëse. Këtë dokument znj. L.S ka refuzuar ta nënshkruaj pasi ka konstatuar se çmimet e orendive ishin jashtëzakonisht të larta dhe ka kërkuar të administrojë dokumentin e paraqitur, por znj. M.M ia ka tërhequr përsëri.*
- 16. Nëpërmjet relacionit nr. 88, datë 11.01.2024 drejtuar Spitalit Psikiatrik Vlorë, znj. L.S ka identifikuar përgjegjësit për djegien e këmbës së pacientes I.J dhe i ka kërkuar znj. M.M ti drejtohet organeve të zbatimit të ligjit për të hetuar rastin.*
- 17. Në datë 11.01.2024, nëpërmjet komunikimit telefonik me SMS, znj. L.S, i është drejtuar Drejtoreshës së institucionit duke i kërkuar, të zbatojë ligjin, dhe të nis hetimin disiplinor për personat përgjegjës referuar rastit më sipër, në të kundërt, do të informonte Avokatin e Popullit dhe Ministrin e Shëndetësisë.*
- 18. Me shkresën nr. 136, datë 16.01.2024, shkresën e datës 23.01.2024, si dhe shkresën nr. 224, datë 26.01.2024, pasi është informuar nga personeli vartës se ndaj tyre nga ana e Drejtorisë së Spitalit Psikiatrik janë marrë masa disiplinore në grup, i ka kërkuar znj. M.M informacion mbi masat disiplinore të marra ndaj punonjësve në lidhje me incidentin e djegies së pacientit si edhe bazën ligjore. Kërkesa këto të dërguara edhe në rrugë elektronike (e-mail).*
- 19. Nëpërmjet komunikimit elektronik (e-mail) znj. M.M refuzon ta informojë me arsyetimin se “...në respektim të parimit të privatësisë dhe konfidencialitetit dosja është personale...”, ndërkohë që kërkesa ishte bazuar në nenin 17.22 të Rregullores së Brendshme.*
- 20. Me shkresën e datës 12.02.2024 i ka kërkuar znj. M.M argumentet dhe bazën ligjore të urdhrit nr. 68, datë 09.02.2024, për transferimin e personelit mjekësor në varësi të znj. L.S, transferim i cili, është kryer në kundërshtim me procedurën dhe ka sjellë si pasojë uljen e cilësisë së shërbimit ndaj pacientëve të pavijonit kronik-burra, ku znj. L.S ishte Shefe Shërbimi.*
- 21. Në datë 14.02.2024, nëpërmjet komunikimit elektronik - SMS, znj. L.S i është drejtuar z. L.R, Drejtor i OSHKSH Vlorë të cilit, i ka referuar veprimet dhe qëndrimet e Drejtoreshës së Spitalit Psikiatrik Vlorë në lidhje me, injorimin e kërkesave të znj. L.S për mungesë përgjegjshmërie në ushtrimin e detyrave me pasojë, uljen e cilësisë së shërbimit ndaj pacientëve.*

22. Asnjë nga kërkesat e parashtruara prej znj. L.S, nuk është marrë në konsideratë nga ana e drejtoreshës, znj. M.M.

III. Shkeljet e evidentuara në marrjen e masave disiplinore dhe mënyrën e zgjidhjes së kontratës:

23. Në orën 17:00 të datës 27.02.2024, në kohën që ka qenë në detyrën e mjekes së rojës, është paraqitur në pranim pacienti S.L në gjendje, post dehje alkoolike, të shoqëruar me çrregullime të sjelljes. E ka mbajtur në observacion për trajtim të mëtejshëm. Në lidhje me protokollin e trajtimit të këtij pacienti kanë lindur kontradikta me shefen e shërbimit akut znj. E.Sh.

24. Në datë 01.03.2024, në orën 13.00, është organizuar mbledhje e stafit mjekësor, në të cilën nuk ka qenë e pranishme për arsye objektive. Referuar komunikimeve telefonike, nga N/drejtori Teknik z. S.L ka marrë njoftimin se mbledhja ishte anuluar, por në fakt mbledhja është organizuar pa praninë e saj dhe tematika e mbledhjes ka qenë veprimet e znj. L.S në ushtrimin e detyrës si mjekë roje në datë 27.02.2024. Në këtë mbledhje nga ana e mjekëve të pranishëm është dalë në përfundimin se: a) ka shkelur protokollin mjekësor të diagnostikimit dhe mjekimit të pacientit S.L, si dhe b) shkelje të etikës profesionale dhe, në këto rrethana nga mjekët është përpiluar dhe nënshkruar një relacion drejtuar drejtoreshës, znj. M.M.

25. Në datën 05.03.2024, në ambientet e Spitalit Psikiatrik është organizuar një tjetër mbledhje e mjekëve të spitalit ku, përsëri, për arsye objektive nuk ka qenë e mundur të marrë pjesë dhe për këtë fakt ka njoftuar eprorët. Edhe në këtë rast ka qenë në padijeni të tematikës së takimit dhe të konkluzioneve të mbledhjes.

26. Në datë 11.03.2024, sheffa e personelit i ka komunikuar znj. L.S masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” të datës 07.03.2024 si dhe Urdhrin nr. 101 datë 11.03.2024 “Për lirimin nga detyra të Shefes së Shërbimit kronik Burra-Gra të znj. L.S”, protokolluar me nr. 676, datë 11.03.2024. E gjendur në këtë situatë, në po këtë datë (11.03.2024) nëpërmjet një shkrese ka kërkuar informacion rreth arsyeve që janë marrë këto dy masa (kërkesa është regjistruar nga Spitali Psikiatrik një ditë më vonë në datë 12.03.2024, me nr. 686 prot.). Në përgjigje të kësaj kërkesë i është vënë në dispozicion “Relacioni” nr. 596, datë 01.03.2024, drejtuar Drejtorisë së Spitalit Psikiatrik Vlorë (nënshkruar nga 6 mjekë), si dhe akti e titulluar “Procesverbal” mbi mbledhjen e zhvilluar në datë 05.03.2024, me nr. 632, datë 06.03.2024.

IV. Analiza ligjore:

27. Nga analiza e akteve të sipërcituara konstatohet se, përveç se në këtë rast nuk është kryer hetim disiplinor sipas kërkesave të ligjit, ndaj znj. L.S në kundërshtim me ligjin janë marrë masa disiplinore me karakter haptas ndëshkimor. Punëdhënësi Spitali Psikiatrik Vlorë, nuk ka kompetencën lëndore për hetimin dhe marrjen e masës ndaj saj. Në hetimin e rastit në fjalë parimisht duhet të ndiqej kjo procedurë: a) Hetimi disiplinor duhej të iniciohej nga subjekti i dëmtuar/cenuar ose çdo subjekt tjetër i interesuar nëpërmjet kërkesës për fillimin e hetimit disiplinor. b) Duhej të identifikohet organi publik i cili gëzon legjitimitetin e kryerjes së hetimit disiplinor. c) Nëse do të finalizohet me vendim i cili konstatonte shkelje konkrete nga ana e një organi publik i cili nuk është punëdhënësi, punëdhënësi do të identifikonte shkeljen e konstatuar nga organi tjetër publik, duke e vlerësuar këtë shkelje në raport me detyrimet të cilat punëmarrësit i burojnë nga kontrata individuale e punës dhe, nga punëdhënësi do të çmohej

- nëse do të vijohej sipas përcaktimeve të nenit 37 të Kodit të Punës, gjithnjë, nëse shkelja konkrete ishte parashikuar njëkohësisht edhe në kontratën e punës.
28. Në rastin konkret, sipas përmbajtjes së Relacionit, rezulton se, iniciatorët e fillimit të hetimit disiplinor ndaj znj. L.S janë mjekët e Spitalit Psikiatrik Vlorë të cilët në mbledhje, pa praninë e saj, kanë diskutuar dhe konkluduar për: a) shkelje të protokollit mjekësor të diagnostikimit dhe mjekimit në shërbimet e shëndetit mendor si edhe, b) çështjes të shkeljes së etikës profesionale, relacioni i përcjellë tek drejtoresha e institucionit.
 29. Në vijim, në datë 05.03.2024, të njëjtët mjekë kanë organizuar një tjetër mbledhje, e cila ka patur si objekt analizën e relacionit të përpiluar prej tyre në datë 01.03.2024, nr. 596, relacioni i hartuar dhe drejtuar drejtores së institucionit. Përgjatë kësaj mbledhje, dokumentuar në procesverbal, rezulton se nga ana e mjekëve janë shprehur konsiderata personale, janë uzurpuar kompetenca, duke shkelur haptasi parimet të cilat normohen në Ligjin 123/2014 “Për Urdhrin e Mjekut”. Kështu ata janë shprehur se znj. L.S ka paaftësi profesionale, shkel protokollin, rrezikon jetën e pacientëve si edhe jepet sugjerimi që të largohet nga shefe e shërbimit kronik. Po në këtë takim në kundërshtim me çdo procedurë ligjore propozohet nga mjekët të ndërmerrej masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna” si edhe “të hiqej nga shefe e shërbimit kronik”.
 30. Nga ana e Drejtores së institucionit znj. M.M, propozimi i mjekëve është pranuar dhe pikërisht në këto rrethana janë emetuar aktet masë disiplinore pra, “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, nr. 649, datë 07.03.2024 dhe akti Urdhër nr. 101, datë 11.03.2024 “Për lirimin nga detyra të Shefes së Shërbimit kronik Burra-Gra të znj. L.S”, të cilat janë ekzekutuar.
 31. Masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra”, edhe nëse Punëdhënësi do të ishte subjekti i legjitimuar për dhënien e saj në kuadër të marrëdhënieve të punës, përsëri ajo është e paligjshme sepse shkelja disiplinore jo vetëm nuk referohet në kontratën kolektive a individuale të punës, apo ndonjë akti tjetër ligjor ose nënligjor, por ajo është e paligjshme sepse punëdhënësi, nuk e ka garantuar punëmarrësin me respektimin e procedurës për marrjen e masës disiplinore sipas nenit 37.2 të Kodit të Punës. Element ky i procesit të rregullt ligjor në respektim të parimit të ligjshmërisë (neni 4.2 i K.Pr.Administrative).
 32. Bazuar sa më sipër në nenin 37.2 të Kodit të Punës dhe të Udhëzimit Nr. 205/2024 (kreu VII, pika 3), punëdhënësi nuk e ka garantuar znj. L.S me respektimin e procedurës nëpërmjet, njoftimit lidhur me fillimin e procedimit, të drejtën për t’u dëgjuar, të drejtën për t’u mbrojtur nëpërmjet paraqitjes së fakteve dhe provave, si dhe të drejtën për t’u ankuar ndaj vendimit përfundimtar. Siç u theksua dhe provohet, të dyja mbledhjet janë mbajtur në mungesë të znj. L.S dhe kjo e fundit nuk është njoftuar në lidhje me fillimin e procedimit disiplinor ndaj saj dhe të drejtën e saj për t’u dëgjuar, si me anë të dhënies së sqarimeve paraprake, ashtu edhe gjatë shqyrtimit të çështjes. Seancat e mbledhjeve të zhvilluara, pa praninë e znj. L.S, janë konsideruar seanca dëgjimore, si respektim i hapave procedurale. Nga ana e punëdhënësit ngatërrohen konceptet, duke u konsideruar seanca e linçimit me seancë të dëgjimit, kur në fakt në respekt të procedurës seanca e dëgjimit nënkupton dëgjimin e pretendimeve të punëmarrësit në një ambient të posaçëm, seancë e cila duhet të fiksohet në procesverbal dhe duhet të përshkruhet nga parimet

- e paanshmërisë, objektivitetit, administrimit të provave dhe respektit ndaj subjektit të hetimit disiplinor.*
33. *Gjatë shqyrtimit të çështjes dhe përpara se të merret vendimi përfundimtar, organi publik duhet të njoftonte znj. L.S lidhur me të drejtën e saj për t'u dëgjuar, njoftim i cili bëhet me shkrim apo me një takim me palën dhe që përmban të dhëna të tilla si, provat e administruara, rezultatet e hetimit, të drejtën për t'u dëgjuar etj. (neni 87 i K.Pr.Admin).*
 34. *Për sa më sipër, Spitali Psikiatrik nuk e ka garantuar znj. L.S në respektimin e procedurës për marrjen e masës disiplinore, pasi kësaj të fundit nuk i është dhënë mundësia për t'u dëgjuar duke parashtruar faktet dhe provat në kuadër të mbrojtjes së saj në lidhje me shkeljet e pretenduara, dhe për më tepër punëdhënësi në arsyetimin e masës disiplinore t'i ketë dhënë përgjigje pretendimeve të znj. L.S.*
 35. *Përkundrazi, në marrjen e masës disiplinore Spitali Psikiatrik nuk ka arsyetuar fare në lidhje me arsyet që merret kjo masë, ku është bazuar, cilat prova dhe fakte ka vlerësuar. Në këtë mënyrë, masa disiplinore është e paligjshme edhe sepse nuk është respektuar forma e aktit i cili duhet të përmbajë ndër të tjera edhe pjesën arsyetuese. (neni 109/c § Neni 99.2/b § Neni 100 i K.Pr.Admin).*
 36. *Sikurse u theksua në rastin konkret, ka shkelje ligjore në lidhje si me organin publik që kryen hetimin disiplinor, i cili në rastin konkret nuk legjitimohet të jetë punëdhënësi për arsyet se: Në ushtrimin e detyrës, mjeku psikiatër zbaton për pacientët të cilët pranon në spital procedurat e përcaktuara në aktin titulluar “Protokoll i kujdesit diagnostik dhe terapeutik për pacientin e axhituar”, si edhe dispozitat e “Kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore”. Nga përmbajtja e aktit me titull “Relacion”, konstatohet se organi i cili duhet të kryente hetimin disiplinor në lidhje me pretendimet për shkelje të “Protokollit të Kujdesit Diagnostik dhe Terapeutik për pacientin e axhituar” duhet të ishte Këshilli Rajonal i Urdhrit të Mjekut Vlorë dhe Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Mjekut. Po kështu edhe në lidhje me pretendimet se ka shkelur rregullat e “Kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore”, kompetent është po ky organ. Kështu në nenin 68 të “Kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore” përcaktohet se: “Çdo akt mjekësor, apo sjellje profesionale në kundërvajtje të dispozitave të këtij kodi, përbën objekt për ndjekje dhe gjykim disiplinor profesional bazuar në ligjin “Për Urdhrin e Mjekëve” dhe në “Rregulloren e gjykimit Profesional të Urdhrit të Mjekëve”. Konkretisht në nenin 4 të ligjit 123/2014 “Për Urdhrin e Mjekëve” përcaktohet misioni: “1. Misioni i Urdhrit të Mjekëve është ruajtja e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesioneve në fushën e mjekësisë dhe mbrojtja e pacientëve dhe publikut nga keq ushtrimi i profesionit të mjekut. 2. Për të përmbushur misionin e tij, Urdhri i Mjekëve ushtron këto kompetenca: a) jep dhe heq licencën individuale të ushtrimit të profesionit; b) vendos standarde etike dhe deontologjike, të detyrueshme për çdo mjek dhe monitoron zbatimin e tyre gjatë ushtrimit të profesionit; Dispozitat e ligjit 123/2014 “Për urdhrin e mjekëve”, përcaktojnë në mënyrë eksplicite mënyrën e fillimit të hetimit disiplinor, masat disiplinore si edhe të drejtën e ankimit, konkretisht: “Neni 16. Komisionet disiplinore: 1. Pranë këshillave rajonale dhe Këshillit Kombëtar funksionojnë komisionet disiplinore si organizma të gjykimit profesional. Komisioni disiplinor rajonal përbëhet nga 9 anëtarë të zgjedhur nga Këshilli Rajonal. Komisioni Disiplinor Kombëtar përbëhet nga 15*

anëtarë të zgjedhur nga Këshilli Kombëtar. 2. Komisioni shqyrton ankesat e bëra nga çdo person apo institucion në organet e Urdhrit, të cilat lidhen me ushtrimin e profesionit dhe përbëjnë shkellje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore. 3. Komisionet disiplinore, pranë këshillave rajonalë, ushtrojnë kompetenca disiplinore të shkallës së parë. Vendimet e tyre janë të apelueshme në komisionin disiplinor të Këshillit Kombëtar, i cili ushtron kompetenca disiplinore të shkallës së dytë. 4. Mënyra e ngritjes dhe funksionimit të komisioneve disiplinore përcaktohet në statutin dhe në rregulloren e gjykimit profesional të Urdhrit. Neni 17. Masat disiplinore: 1. Komisioni disiplinor heton dhe gjykon në bazë të fakteve e provave të administruara dhe seancës dëgjimore me anëtarin e Urdhrit, ndaj të cilit mund të merret masa disiplinore. Kur vërtetohet se anëtari ka kryer shkellje të etikës, të Kodit Etik dhe Deontologjik ose ka bërë gabime teknike, ai jep këto masa: a) vërejtje me shkrim; b) vërejtje me paralajmërim; c) gjobë nga 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë deri 100.000 (njëqind mijë) lekë; ç) propozim për shkarkim nga funksione drejtuese në institucione shëndetësore publike dhe private. d) pezullim nga e drejta e zgjedhjes në organet drejtuese të Urdhrit të Mjekëve deri në 3 vjet. dh) përrjashtim nga Urdhri i Mjekëve për një periudhë deri në 3 vjet. 2. Përveç masave të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, si masë plotësuese, komisioni ka të drejtë t'u caktojë të ndëshkuarve kryerjen e një rikualifikimi ose të studimeve plotësuese, të barabarta me 20 kredite. 3. Masat disiplinore, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, mund të shlyhen në qoftë se ndaj anëtarit nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore: i) brenda 1 viti nga data e dhënies së tyre, për shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij neni; ii) brenda 3 vjetëve nga data e dhënies së tyre, për shkronjat “ç”, “d” e “dh”, të pikës 1, të këtij neni. 4. Gjoka e vendosur sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij neni, derdhet në Buxhetin e Shtetit. Neni 18. Ankimi: 1. Ankesat kundër vendimeve për marrjen e masave disiplinore nga komisioni disiplinor i këshillit rajonal paraqiten në komisionin disiplinor të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve brenda 15 ditëve nga data e komunikimit me shkrim të vendimit. 2. Komisioni disiplinor, brenda 60 ditëve nga data e marrjes së ankesës, detyrohet të japë vendimin për ankesën e paraqitur. Vendimi i komisionit disiplinor të Këshillit Kombëtar ankimohet në gjykatën kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative. Pra për rastin e relatuar si shkellje protokollit, marrja e masave disiplinore sipas dispozitave “Për urdhrin e mjekut”, (edhe sikur të ishte finalizuar me masë disiplinore), nuk sjell pasoja në marrëdhëniet si punëdhënës-punëmarrës në Spitalin Psikiatrin Vlorë, por sjellin pasoja në lidhje me licencimin e mjekut dhe vetëm në rastin e germës “dh” të nenit 17 “përrjashtim nga Urdhri i Mjekëve për një periudhë deri në 3 vjet”, kjo masë disiplinore përbën shkak për zgjidhjen e kontratës midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, pasi specifikisht për kryerjen e detyrës si mjek psikiatër kërkohet licenca profesionale, mungesa e të cilës shpie në zgjidhjen e menjëhershme të kontratës individuale të punës.

37. Referuar kontratës individuale të punës, në asnjë nga dispozitat e saj nuk specifikohet si kusht pa të cilin mund të sillte pasoja për punëmarrësin në marrëdhëniet e punës, (veç nenit 17 germa “dh” të ligjit Për Urdhrin e Mjekut) shkellja e protokollit mjekësor dhe kodit të etikës dhe deontologjisë edhe sikur masa disiplinore të ishte marrë nga Urdhri i Mjekut. Kështu në nenin 7 të kontratës individuale përcaktohet se: “Punëmarrësi ka për detyrë të zbatojë orarin e punës,

të mirëmbajë vendin e punës dhe dokumentet përkatëse, të mos lërë në mënyrë të pajustificuar vendin e punës dhe të zbatojë dispozitat në fuqi për marrëdhëniet e punës”.

38. Duke iu rikthyer çështjes nga mjekët e Spitalit Psikiatrik Vlorë i janë relatuar punëdhënësit shkëlqej nga ana e znj. L.S dhe është propozuar të iniciohet fillimi disiplinor me pretendimin e shkëlqejes se protokollit mjekësor dhe etikës profesionale, dhe titullarja e institucionit nga ana e vet edhe pse në mungesë të kompetencës për shqyrtimin e rastit, pa procedurë ligjore ka ndërmarrë sanksione. Nga ana tjetër nga mjekët janë shkelur detyrimet e përcaktuara në nenin 10 të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë: “Mjekët kanë për detyrë të mbajnë marrëdhënie të mira me njëri tjetrin dhe me anëtarët e tjerë të personelit mjekësor, duke respektuar pavarësinë profesionale të secilit, në interes të të sëmurëve dhe ruajtjes së emrit të mirë të profesionit dhe të institucionit mjekësor”. Mjekët sipas këtij kodi të etikës kanë liri dhe pavarësi profesionale edhe në procedurat e diagnostikimit e mjekimit të të sëmurëve (neni 12 § 42 të KEDM).

Episodi i dytë - Rrethanat e faktit:

39. Në datë 31.03.2024 është paraqitur në pranim paciente M.Sh, me diagnozë “çrregullim bipolar, episod maniakal në person grvide 32 javësh”, (shtatzënë), të cilën znj. L.S e shtroi urgjent.
40. Në datë 22.04.2024 bëhet konsultë e përgjithshme ku vendoset se pacientja sapo të hyjë në muajin e nëntë të bëjë konsultë gjinekologu dhe të planifikohet lindja nën asistencën e gjinekologut dhe psikiatrit dhe në datë 14.05.2024 planifikohet lindja cezariane në spitalin obstetrik Vlorë, e cila do të kryhej në datë 24.05.2024, ku prania e mjekes kuruese psikiatre znj. L.S ishte e detyrueshme. Sa më sipër është evidentuar në kartelën klinike dhe i është referuar shefes së shërbimit akut me shkrim në kartelë.
41. Në datë 24.05.2024, ndërkohë që ishte në shërbim në Spitalin Psikiatrik Vlorë, është thirrur në drejtori nga znj. M.M e cila i ka komunikuar se kishte braktisur vendin e shërbimit dhe në prani të sekretares është mbajtur procesverbal, pra bëhet fjalë për periudhën kohore ora 08.00 deri në orën 11.10 të datës 24.05.2024, orë në të cilën ka qenë duke ushtruar detyrën e mjekut kurues pranë pacientes që ndodhej në Spitalin Rajonal Vlorë.
42. Në datë 28.05.2024, shefe e personelit i ka dorëzuar shkresën me nr. 1233, datë 27.05.2024 të masës disiplinore “Vërejtje”.

Arsyetimi ligjor në lidhje me shkeljet ligjore të konstatuara në marrjen e masës disiplinore:

43. Për shkak të kësaj mungese nga shërbimi prej 3 orësh për të asistuar pacienten M.Sh për të lindur në datë 27.05.2024, punëdhënësi ka filluar hetimin disiplinor për shkeljen e cila rregullohet në marrëdhëniet e punës nga kontrata individuale e punës, për braktisje të vendit të punës dhe ndaj znj. L.S është marrë masa tjetër disiplinore “vërejtje”.
44. Edhe në lidhje me këtë masë, Drejtoresha nuk ka garantuar znj. L.S me respektimin e procedurës sepse në thelb, realisht nuk është dëgjuar. Kjo pasi, ndërsa nga ana e znj. L.S u pretendua fakti i njoftimit të Shefave të Shërbimit dhe nga ana e Shefave të Shërbimit që znj. L.S nuk i kishte njoftuar-ndërkohë që pacientët prisnin për disa orë - ka vendosur të pranojë pretendimet e Shefave të cilët kishin motiv të pretendonin të kundërtën për t’ju shmangur përgjegjësisë. Kjo pasi, në nenin 17.10 § 17.12 § 17.13 §18.5 § 33.1 i Urdhrit Nr. 11, datë 10.10.2013 “Për miratimin e rregullores së brendshme të Spitalit Psikiatrik Vlorë” janë

parashikuar edhe detyrat që kanë Shefat e Shërbimit dhe që lidhen me faktin se duhet të dinë çfarë bëhet në institucion për shkak edhe të pozicionit që ata mbajnë. Kështu, në këtë nen është parashikuar se: “Detyrat dhe kompetencat e shefit të shërbimit janë... Bashkëpunon dhe bashkërendon punën me shërbimet e tjera që... Kontrollon kartelat e të sëmurve... Një herë në javë bën vizitë të përbashkët me shefat e repartit dhe mjek kurues... shefi i shërbimit bën grafikun e rojeve”. Grafiku i rojeve gjithashtu është i shpallur në ambientin e konsultave psikiatrike pikërisht për këtë arsye, që në çdo rast të mund të dihet ky fakt që të mund të merren paraprakisht masat organizative sipas rastit.

45. Në rastin konkret trajtimi që i është bërë znj. L.S në raport me Shefat e Shërbimit nuk është i drejtë sepse sipas parashikimeve ligjore më sipër, prezumohet që Shefat e Shërbimit janë në dijeni të mungesës së znj. L.S dhe fakti që pacientët prisnin për disa orë për të bërë vizitat nuk ka ardhur për shkak të ndonjë faji të znj. L.S që kishte vajtur me detyrë të planifikuar në datë 24.05.2024 në Spitalin Rajonal Vlorë, por, është për shkak të Shefave të Shërbimit që kanë neglizhuar të përmbushin detyrat e tyre në organizimin e duhur të punës në institucion.
46. Në rastin konkret çmujmë se është shkelur procedura në lidhje me kompetencën e organit që shqyrton shkeljen e konstatuar. Duke qenë se mungesa e znj. L.S ishte e planifikuar në konsulta mjekësore, e evidentuar në kartelën klinike, ky largim përbën sjellje profesionale e diktuar nga rrethana konkrete që lidhen me asistencën në lindje të pacientes M.SH, paciente e cila lindi në datë 24.05.2024 në spitalin Obstetrik Vlorë, në praninë e detyrueshme si pjesë e ekipit mjekësor edhe të psikiatër znj. L.S. Pra “braktisja e vendit të shërbimit” duhet të referohej pranë Urdhrit të Mjekut me qëllim hetimin disiplinor.

Episodi III

47. Në datë 24.05.2024 është paraqitur në urgjencë pacienti R.V me diagnozë “çrregullim personaliteti, me periudha dekompesimi psikotik në person që ka abuzuar në substancë cannabiss cattiva, heroinë”.
48. Në datë 27.05.2024 është konstatuar nga mjeke znj. L.S se pacienti veç problemeve psikike, kishte shfaqur probleme dermatologjike të cilat kërkonin asistencën e një mjeku të Spitalit Rajonal Vlorë. Në këto rrethana, pasi bëri analizën e riskut të pacientit, të cilën e ka evidentuar në kartelën e pacientit dhe ka çmuar se pacienti nuk përbënte rrezikshmëri të lartë sipas standardeve që mjeku çmon rast pas rasti, ka urdhëruar kryeinfermierin e pavijonit të organizonte transportin e pacientit tek mjeku përkatës dhe kështu është vepruar. Pasi pacienti ka marrë asistencën mjekësore, në kthim për spital është konfliktuar me drejtuesin e ambulancës së transportit dhe kujdestarin i cili e shoqëronte.
49. Në datë 29.05.2024 u organizua mbledhje me procesverbal dhe mjekët përpiluan një relacion me nr. 1254, të cilin e dorëzuan në zyrën e Drejtorit të institucionit, znj. M.M në të cilën kanë shprehur gjykime profesionale në lidhje me rastin, duke fajësuar znj. L.S në lidhje me analizën e riskut për këtë pacient.
50. Në këtë mënyrë, në vijim të sjelljeve agresive dhe diskriminuese, por edhe joligjore mjekët kanë shkelur nenin 10 të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë sipas të cilit: “Mjekët kanë për detyrë të mbajnë marrëdhënie të mira me njëri tjetrin dhe me anëtarët e tjerë të personalit mjekësor, duke respektuar pavarësinë profesionale të secilit, në interes të të sëmurve dhe ruajtjes së emrit të

mirë të profesionit dhe të institucionit mjekësor”. Pavarësisht se në rastin konkret nuk u iniciua hetim disiplinor ndaj znj. L.S, aktet e përpiluara i janë referuar Ministrisë së Shëndetësisë me qëllim uljen dhe denigrimin e figurës nga ana profesionale për të plotësuar kështu një mozaik të tërë provash jo korrekte dhe jo ligjore në seri të cilat shërbyen si bazë për zgjidhjen e kontratës së punës nga ana e znj. M.M. Kështu në Urdhrin nr. 188, datë 30.05.2024 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të Punës”, citohet se si bazë për këtë vendim-marrje ka qenë edhe relacioni nr. 1254, datë 29.04.2024. Edhe ky episod duhet të relatohej pranë “Urdhrit të mjekut” me qëllim hetimin disiplinor për arsye se kanë bërë gjykime profesionale mbi analizën e riskut për pacientin i cili trajtohej nga mjeke psikiatre znj. L.S.

51. Ndaj znj. L.S është kryer diskriminim për shkaqe parimore, i cili shprehet qartë në procedurat për marrjen e masave disiplinore si dhe “Urdhrin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës”, të cilat janë kryer në mënyrë haptas në kundërshtim me ligjin për respektimin e procedurës, sikurse është argumentuar më lartë dhe provuar me provat bashkëlidhur.
52. Rezulton e provuar se ka një tërësi veprimesh dhe aktesh shkresore të emetuara nga punëdhënësi të cilat të marra në unitet vërtetojnë synimin e punëdhënësit jo vetëm për ta përligjur juridikisht këtë sjellje diskriminuese, por me objektiv fundor për të ndërprerë marrëdhëniet e punës me punëmarrësin. Kështu, me qëllim që të përligjej ndërprerja e marrëdhënieve të punës për shkaqe të justifikuara, sipas kërkesave të nenit 153 të Kodit të Punës, nga punëdhënësi është vepruar me një plan afatgjatë. Duke evidentuar fakte në periudha kohore të ndryshme të cilat sipas punëdhënësit përbëjnë shkelje të detyrimeve kontraktuale, fakte për të cilat ka marrë masat disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” dhe “Vërejtje”. Të dy këto masa përbëjnë anën formale të dispozitës, për të përligjur pra, ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës.
53. Në fakt rezulton e provuar se: së pari, për nga rëndësia masat disiplinore janë të paligjshme sepse janë marrë në kundërshtim me procedurën ligjore nga punëdhënësi, së dyti, hetimi disiplinor në të tre episode megjithëse nuk është në kompetencën lëndore të punëdhënësit, është kryer prej punëdhënësit, së treti, në asnjë rast nga punëdhënësi nuk është marrë në analizë faji në të dy format e tij si element i domosdoshëm i çdo shkelje disiplinore, por edhe si element themelor mbi bazën e të cilit konfigurohen shkaqet e justifikuara për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.
54. Në sjelljen dhe veprimet denigruese dhe diskriminuese ndaj ankueses, znj. M.M dhe kolegët kanë patur ndërveprim. Kështu, megjithëse në aktet të cilat i relatonin znj. M.M me cilësinë e Drejtorit të institucionit, shprehnin konsiderata profesionale me përmbajtje fyese dhe denigruese, të cilat shkelnin Kodin e Etikës dhe Deontologjisë si edhe propozime konkrete për masa disiplinore të rënda deri në largim nga puna, drejtori i institucionit, i cili është i diplomuar si jurist, që nënkupton njohjen e akteve ligjore e nënligjore, jo vetëm nuk ka marrë masa për ndërprerjen e diskriminimit dhe marrjen në mbrojtje, por ka qenë vetë aktori kryesor i ushtrimit të diskriminimit, e materializuar në sjellje konkrete e ndërveprim fyjes, aktet administrative ndëshkuese, të cilat kulmuan me zgjidhjen e kontratës së punës, zgjidhje kjo në kundërshtim me çdo procedurë ligjore. Vërtetohet se midis tyre ka patur dhe ka bashkëpunim në këtë veprimtari

diskriminuere, bashkëpunim i cili diktohet nga marrëdhëniet e interesit dhe raportet epror-vartës.

Episodi IV:

55. Në datë 29.04.2024 kolegët “....shumë të indinjuar, të fyer dhe të shantazhuar si edhe të traumatizuar psikologjikisht nga intervista e dhënë në Top Albania Radio” paraqesin një Kërkesë Urgjente nr. 1042, datë 29.04.2024, këtë rast adresuar Ministrisë së Shëndetësisë, Urdhrit të Mjekut, Avokatit të Popullit, Drejtorisë Rajonale të Kujdesit Shëndetësor, si edhe Drejtorit të Spitalit Psikiatrik Vlorë, e cila po paraqitet në cilësinë e provës ku kërkohet të shqyrtohet rasti në fjalë dhe të merren masa urgjente mbi aftësinë profesionale, etikën, komunikimin me kolegët dhe eprorët. Në thelb kjo shkresë përbën një kërkesë për fillimin e hetimit disiplinor. Pasi kjo shkresë është administruar në Ministrinë e Shëndetësisë, Ministria e Shëndetësisë me shkresën Nr. Gr-13/1, datë 27.05.2024 drejtuar DROSHKSH Vlorë, nëpërmjet të cilës sugjeron Drejtorinë e Spitalit Psikiatrik Vlorë, të marrë masa për shqyrtimin e problematikës sipas akteve ligjore dhe nënligjore. Pra edhe pse shkresa i është dërguar DROSHKSH-së Vlorë, kjo drejtori nuk ka vepruar, por është orientuar Spitali Psikiatrik Vlorë të marrë masa për shqyrtimin e problematikës dhe për hetimin disiplinor. Pas këtij momenti Drejtori i Spitalit, duke pretenduar se kjo shkresë përbën bazë ligjore për ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës, në datë 30.05.2024, ka emetuar Urdhër nr. 188 “Për ndërprerje të marrëdhënieve të punës”. Në marrjen e masës disiplinore Spitali Psikiatrik nuk ka arsyetuar fare në lidhje me arsyet që merret kjo masë, ku është bazuar, cilat prova dhe fakte ka vlerësuar. Në këtë mënyrë masa disiplinore është e paligjshme edhe sepse nuk është respektuar forma e aktit i cili duhet të përmbajë ndër të tjera edhe pjesën arsyetuese.
56. Këtë situatë diskriminuere ndaj mjekes psikiatre znj. L.S e paraprin një tjetër episod me sfond diskriminues. Pasi një kopje e “Kërkesës Urgjente” datë 29.04.2024 i ka mbërritur DROSHKSH Vlorë, në datë 30.04.2024, vetë Drejtori i këtij institucioni z. L.R mbërrin në psikiatri dhe organizohet mbledhje. Në mbledhjen e datës 30.04.2024, mbledhje në të cilën ka qenë i pranishëm dhe Drejtori Spitalit znj. M.M, si edhe mjekët, është intimiduar, është atakuar në grup për paaftësi profesionale, për shkelje të protokolleve mjekësore të diagnostikimit dhe mjekimit si edhe çështje të shkeljes së etikës profesionale të znj. L.S. Shkak i këtij takimi, ku edhe z. L.R ka qenë në unison me anëtarët e tjerë, ka qenë jo vetëm çfarë citohej në “Shkresën urgjente”, por edhe një intervistë të cilën e ka dhënë në Top Albania Radio, të cilën po jua vëmë në dispozicion. Megjithëse sikurse mund të gjykohet dhe konstatohet lehtësisht nuk ka kryer asnjë shkelje dhe nuk ka fyer askënd, nuk ka cenuar integritetin e asnjë personi, nuk ka nxjerrë të dhëna sensitive apo me karakter personal, nuk ka denigruar institucionin apo persona të veçantë ndër ta edhe mjekët, por vetëm ka reklamuar faktin se ka shfrytëzuar mjetet ligjore me qëllim mbrojtjen e të drejtave, kjo është konsideruar shkelje e rëndë dhe për këtë shkak është sulmuar në grup. Dukshëm dhe shumë qartë edhe një herë në këtë akt shkresor “Kërkesë urgjente” vërtetojnë diskriminimin koherent, për të cilin ritheksohet se megjithëse Drejtori i Institucionit znj. M.M ka qenë në dijeni, jo vetëm nuk ka marrë masa për ta parandaluar, por e ka dirigjuar derisa ka mbërritur në zgjidhjen e kontratës me pasoja shumë të rënda social-ekonomike dhe psikologjike për ankuesen, të cilën e kanë diskriminuar për shkaqe parimore, nëpërmjet sjelljeve,

shprehjeve dhe veprimeve denigruese dhe poshtëruese, deri me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës duke e ekspozuar përballë urisë duke i hequr të drejtën të jetoj në kushte normale, të ushtrij profesionin për të cilin ka studiuar dhe ka punuar për 33 vite. Në formularin e vlerësimit të punës, datë 22.01.2024, i vlerësuar dhe nënshkruar nga nëndrejtori Teknik z. S.L, mbi indikatorët dhe rezultatet si edhe sjelljen, ka marrë vlerësimin maksimal, fakt të cilin e vërtetojmë me aktin shkresor.

57. *Fakti më i rëndë është se mjekët të cilët relatojnë shkelje koherente të protokollit gjatë ushtrimit të detyrës, nga ana znj. L.S si mjekje psikiatre e licencuar, duke i dhënë attribute vetes së tyre si ekspertë në fushën e psikiatrisë, jo vetëm nuk zotërojnë licencën profesionale, por nga Drejtori i Institucionit znj. M.M janë caktuar në detyra të cilat duhen detyrimisht të ushtrohen nga mjekë psikiatër të licencuar. Sipas shkresës nr. 41/1, datë 25.04.2024 të Urdhrit të Mjekut: znj. D.B është në proces licencimi që nënkupton që nuk zotëron licencën profesionale si mjekje psikiatër; znj N.V, nuk disponon licencë profesionale si mjekje psikiatre; znj. E.T nuk zotëron licencë profesionale psikiatri; z. S.T nuk është i pajisur me licencë profesionale si mjek psikiatër. (Ndërkohë që z. S.T mban dy cilësi, është edhe nëndrejtor teknik pranë Spitalit Psikiatrik Vlore, post i cili duhet të mbahet nga mjek psikiatër, është edhe Përgjegjës i Qendrës Komunitare të Shëndetit Publik Vlorë. Në të dy këto pozicione pune duhet të zbatojë orarin dhe prezencën 08.00-16.00 çdo ditë kalendarike).*
58. *Për të gjitha këto fakte është në dijeni titullari i institucionit. Katër nga gjashtë mjekët të cilët në mënyrë koherente e kanë gjykuar profesionalisht dhe kanë përpiluar edhe kërkesën urgjente drejtuar Ministrisë të Shëndetësisë nuk kanë autoritetin të japin gjykime profesionale mbi zbatimin e protokolleve mjekësore dhe të arrijnë në fyerje të artikuluar me shprehje fyese të tillë si “bën shkencë përmes formave të trajtimit të pacienteve”, sepse në asnjë rast nuk ka artikuluar fjalor dhe qëndrim të tillë, aq më tepër të shpifin në lidhje me veprimtarinë profesionale.*
59. *Por përtej faktit se mungesa e licencave profesionale, nuk i legjitimon të japin konsiderata për shkelje të protokollit, kjo mungesë e licencave ka lidhje me elementë të karakterit ekonomik të cilat kanë të bëjnë me mënyrën e pagesës së mjekëve të përgjithshëm në raport me mjekët të cilët zotërojnë licencë profesionale, pagesë e cila është e diferencuar për kategori të ndryshme. Kjo përcaktohet në VKM nr. 555 datë 11.08.2011 “Mbi miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të personelit mjekësor....”, ku diferencat bëhen në tabelat e Lidhjes 1 (kreu 1.4) pika 9 dhe tabelat e lidhjes 1 (Kreu 1.1). Listë pagesat e personelit të Spitalit Psikiatrik mbikëqyren nga titullari i institucionit i cili ka detyrimin të verifikojë mënyrën e pagesës dhe aktet ligjore mbi bazën e të cilave kryhet pagesa. Pikërisht këto toleranca të titullarit ndaj vartësve mendojmë se krijojnë klimën e duhur për të përkrahur punëdhënësin në veprimet diskriminuese të ndërmarra ndaj znj. L.S”.*
- *Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 894/7, datë*

30.09.2024 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 09.10.2024⁶, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Seanca u zhvillua me praninë e palëve në proces: ankuesja znj. L.S dhe përfaqësuesve të saj Av. Th.Dh dhe Av. A.P dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësuesve me autorizimin nr. 2263, datë 08.10.2024, të Spitalit Psikiatrik Vlorë, z. S.T, Nën/Dr.Teknik, znj. E.Sh, Shefe Shërbimi dhe znj. P.M, Juriste e institucionit.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, palët i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe me e-mail me KMD-në, që do të shtjellohen në vijim.

Në vijim, Spitali Psikiatrik Vlorë, me shkresën nr. 2377, datë 17.10.2024, në mes të tjerash informoi se: *“Zgjidhja e kontratës së punës me ankuesen në datë 30.05.2024, nuk është si rezultat i diskriminimit në kuptimin ligjor për Mbrojtjen nga Diskriminimi, por një proces shkeljesh disiplinore të kryera prej saj.*

Në ankesën e bërë jepet një tablo për masat disiplinore që në kuadër të marrëdhënieve të punës janë marrë ndaj saj, theksojmë vetëm në kuadër të marrëdhënieve të punës.

Me parashtrimet që ankuesja bën në këtë ankim rezulton në konkluzionin e qartë se, çdo masë disiplinore që është marrë ndaj saj ka ardhur si rezultat i shkeljeve të rënda të disiplinës në punë (shkelje të etikës të protokolleve të mjekimit) që vetë ajo ka bërë. Madje, edhe qëndrimi i saj ka qenë i gabuar, pasi në asnjë rast prej vendimeve të marra nuk ka patur asnjë element të diskriminimit. Masat e marra nga drejtoria kanë qenë si rrjedhojë e problematikave të krijuara nga vetë ajo në institucion, lidhur me zbatimin e protokolleve të mjekimeve, shkeljes së etikës profesionale dhe asaj të komunikimit, si dhe sjelljes në një administratë shtetërore.

Duam t’ju bëjmë me dije se, mjekja në fjalë gjatë gjithë viteve të punës në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, në mënyrë të herëpashershme ka marrë masa disiplinore të tilla si, “tërheqje vëmendje”, “vërejtje” dhe “pezullime”, nga të gjithë drejtuesit e mëparshëm me të cilët ajo ka qenë e punësuar dhe ka krijuar konflikte të vazhdueshme, nisur që me eprorë, kolegë, stafin mjekësor, staf psiko-social.

- 1. Përsa i përket paragrafit të II-të dhe III-të do t’ju vendosim në dispozicion masat disiplinore të marra në periudha kohore të ndryshme, të cilat konsiderohen të shuara si afat kohor, por, janë aq shumë në numër sa tregojnë problematikën e saj ndër vite, në lidhje me etikën e komunikimit dhe ndërveprimin me stafin, eprorët, kolegët dhe vartësit, gjë që nuk përbën rastësi apo subjektivizëm të lidhur me ndryshimin e drejtuesit për masat e marra pikërisht me znj. L.S.*

⁶ Seanca e planifikuar për tu zhvilluar në datë 19.09.2024, për arsye objektive u shty për tu zhvilluar në datë 09.10.2024.

2. Për sa i përket vlerësimit maksimal, sqarojmë se, ankuesja gjatë periudhës prej 17 vite që punon në këtë institucion, ka vetëm një vlerësim 6-mujor për periudhën Korrik-Dhjetor 2023, ndërsa nuk ka deklaruar se sa masa disiplinore ka marrë. Gjithashtu duam t'ju bëjmë me dije se kjo periudhë, 5 muaj i përket periudhës që institucioni drejtohej nga znj. O.G. Për herë të parë me ndërrimin e drejtuesit u kërkua vlerësimi në punë.
3. Në lidhje me pikat 4 dhe 5, Ju bëjmë me dije se, edhe për këtë kemi provën bashkëlidhur që është deklarata e z. E.H. Sqarojmë se deponimin për dhënien e rakisë nga znj. L.S e ka bërë ky person në atë kohë me detyrë Kryeinfermier i pranim-urgjencës. Gjithashtu në këtë deklaratë keni shumë hollësira se urdhri i është dhënë verbalisht prej saj kryeinfermierit dhe stafit mjekësor dhe bidonin e rakisë e ka sjellë vetë znj. L.S dhe ia ka dhënë në dorë kryeinfermierit. Në materialin e dorëzuar nga pala përfaqësuese për ankimin pranë institucionit tuaj është pranuar me shkrim se i ka dhënë alkol (raki) pacientit në pavion, çka do të thotë se kërkesa e palës akuzuese duket e pavend për t'u njohur me deklaratat e personelit. (Bashkëlidhur deklarata)
4. Po t'i referohemi dokumentacioneve në pranim rezulton se në librin e observacionit, ajo ka vënë diagnozën "encefalopatia Wernice". Theksojmë se kjo diagnozë është kompetencë e neurologut dhe jo e saj. Ajo pretendon për çrregullime të sjelljes, por në asnjë përshkrim të kartelës së observacionit nuk ka çrregullime të sjelljes të shkruar prej saj dhe stafit të urgjencës psikiatrike. Madje, edhe terapia që është vendosur në hyrje nuk përkon me terapinë e një urgjence psikiatrike. Medikamentet duhet të përshkruhet vetëm nga mjeku neurolog.

Znj. L.S e ka mbajtur pacientin duke shkelur Ligjin e Shëndetit Mendor, duke i mohuar të drejtën e trajtimit në adiktologji (trajtim për alkolin) dhe duke i rrezikuar seriozisht jetën e tij. Pra, znj. L.S jo vetëm që nuk është diskriminuar në asnjë moment, por është ajo që ka shkelur të drejtat e të sëmurit dhe e ka trajtuar urgjencën psikiatrike si një pronë për të bërë qokat e saj. Njohja e hierarkisë dhe rregullores së spitalit nuk kanë qenë aspak në fokus për t'u përmbushur për sa kohë i ka lejuar vetes nën petkun e bluzës së bardhë të kryejë veprime që ajo vetë i ka quajtur "po bëj shkencë duke dhënë raki".

Me këtë terapi na krijohet përshtypja se jemi në urgjencën toksikologjike dhe jo atë psikiatrike. Në ditët në vazhdim terapia e pacientit është pothuajse e njëjtë, ndërsa në dalje nga spitali si për çudi znj. L.S e ka nxjerrë pacientin me diagnozën "dehje alkolike me çrregullime të sjelljes". Kjo diagnozë e shkruar prej saj bie në kundërshtim me deklaratën e saj dhe të avokatëve të saj, të cilët në ballafaqimin me Komisionerin deklaruan se pacienti kishte dy ditë që nuk pinte alkol. Ndërsa në dokumentacion mjekësor paraqet se "ka ardhur i dehur në spital". Pra, vihet re një diskordancë midis dokumentacionit, deponimeve dhe pretendimeve të saj dhe të avokatëve të saj. Ju bëjmë me dije se përdorimi i detyrës së mjekut për të kryer e marrë përsipër veprime që e tejkalojnë kompetencën e specialitetit sjell pasoja të rënda, ku jo vetëm pacienti dëmtohet, por hidhet "baltë" mbi një shërbim të tërë. Po kështu mjekime të tilla të pakujdesshme cilësohen dhe konsiderohen shkelje të rënda në përmbushje të detyrës duke sjellë shpërdorim të detyrës sipas Kodit Penal.

5. Përsa i përket pikës 6, sqarojmë se nuk i është bërë asnjë pyetje përçmuese, por ajo ka detyrimin që mbështetur në detyrat dhe të drejtat e mjekut në pavionin e urgjencës psikiatrike dhe shefit të shërbimit (në rregulloren e brendshme të spitalit) të prezantojë rastet para shefit të shërbimit dhe problematikat e tyre, gjë të cilën nuk e ka bërë. Gjithashtu, ajo ka detyrim ligjor që të zbatojë Rregulloren e Shërbimeve Shëndetësore Psikiatrike me Shtretër, dhe Protokollet e Mjekimit (të dyja këto të miratuara nga MSHMS), si dhe nëse vendos të aplikojë terapi në kundërshtim me protokollin e një urgjence psikiatrike duhet të vërë në dijeni shefen e shërbimit, Ka qenë znj. L.S ajo që ka ofenduar me fjalor banal, dhe kur është thirrur nga Ndëdrejtori Teknik për të diskutuar problemin, ajo është larguar në mënyrë arrogante dhe fyese. (Bashkëlidhur sms).
6. Në lidhje me njoftimet për mbledhje, sqarojmë se është lajmëruar gjithmonë nga Shefja e Personelit, por znj. L.S nuk është paraqitur me pretendime të pajustificueshme. Theksojmë se Autoriteti nuk është i detyruar të lajmërojë paraprakisht për tematikën e mbledhjes, pasi gjatë orarit të punës 08:00-15:30 mund t'i thërrasë mjekët/stafin në çdo kohë, madje dhe urgjent për shkelje të rënda të etikës apo të protokolleve, por mjekja në fjalë asnjëherë nuk gjendej në orarin e punës (madje gjatë orarit të punës bënte vizita private në klinikën e saj që gjendet deri në 150m larg spitalit. (Bashkëlidhur foto të klinikës private).

Raportimi i pacientes I.J nuk është bërë nga znj. L.S, por nga një mjeke tjetër e cila ka qenë roje, ndërsa pretendimi se ka qenë znj. L.S që ka njoftuar drejtorinë është i pavërtetë. (Bashkëlidhur procesverbali përkatës). Madje, znj. L.S e dinte dhe me qëllim nuk kishte njoftuar personat përkatës.

7. Referuar të gjithë dokumentacionit përkatës që disponohet në institucion në lidhje me firmosjen për arredimin e shtëpive të mbrojtura, nuk ekziston asnjë dokument i firmosur nga ana e znj. L.S, përveç dokumentit që ka qenë Kryetare për saktësimin e ngjyrave të mobilimit, me një grup tjetër mjekësh dhe staf psiko-social, për të cilën ju vëmë në dispozicion dokumentin përkatës të datës 04.01.2024. Në asnjë moment nuk ka patur hezitim për tu përfshirë në këtë detyrë të lënë madje si kryetare e grupit të punës ka dorëzuar kërkesat me specifikimet përkatëse për mobilimin e pavionit psikiatrik. Drejtori nuk është personi që merret direkt me shpërndarjen dhe marrjen e materialit të punuar nga grupet e punës. Në asnjë vend të ligjeve dhe rregulloreve nuk citohet se drejtuesi shkon tek vartësit dhe shpërndan shkresa.
8. Lidhur me pretendimin e saj që është detyruar të firmosi në lidhje me tenderin e mobilimit, nisur nga vetë fakti, barra e provës i takon palës pretenduese të provojë faktet, në të cilat bazon pretendimin e saj. Përbërja e komisionit përfshinte ekipin multidisiplinar që ofronte shërbimin në pavionin kronik. Për shkak të respektimit të ligjit të Prokurimit Publik, prokurime të tilla nuk kryhen nga ana e administratës së spitalit, ato janë blerje të përqendruara ku një organ tjetër është ai që realizon procedurën, prandaj pretendimi se nga ana e drejtorisë është diskriminuar për këtë fakt jo vetëm që është i pabazuar, por konsiderohet shpifje.

9. Me datë 24.05.2024, znj. L.S kishte shërbimin 24-orësh dhe po në këtë datë pacienti M.Sh duhet të paraqitej pranë Spitalit Rajonal të Vlorës për lindje, e cila është shoqëruar vetëm nga infermiera znj. E.T. Prej orës 08:30-11.00, kjo mjeke nuk ka qenë as në Spitalin Psikiatrik për të kryer shërbimin dhe as në Spitalin Rajonal të Vlorës për të qenë afër pacientes, si dhe nuk ka lajmëruar asnjë nga shefat e shërbimit se nuk do të ishte prezente në spital.
10. Për sa i përket pikës 13, sqarojmë se, vetë znj. L.S e ka shtruar pacientin R.V dhe ka përshkruar në kartelë rrezikshmërinë e tij “është paraqitur në pranim urgjence me armë të ftohtë thikë, shumë i ashpër në sjellje me fjalor banal” dhe po kjo mjeke ka rrezikuar stafin kujdestarë dhe shoferë duke e nxjerrë pacientin jashtë Spitalit Psikiatrik për urtikariet. Në mbledhjen e Këshillit Teknik mbi rastin në fjalë, nga znj. L.S u pranua se ky pacient ishte i rrezikshëm dhe se stafi kishte të drejtë që ishte i indinjuar, pasoja këto të veprimeve dhe mosveprimeve nga ana e pretendueses për diskriminim. (Bashkëlidhur deklaratat e stafit dhe procesverbali i mbledhjes).

Pra, brenda një periudhe të shkurtër Prill-Maj 2024 kjo mjeke ka treguar moskorrektësi në punë, papërgjegjshmëri deri në rrezik të jetës së personelit, arrogancë dhe shkelje të etikës. Sjellje këto që janë flagrante dhe në mënyrë të hapur cenojnë jo vetëm jetën dhe shëndetin e pacientëve por edhe të punonjësve. Sjellje të tilla rrezikojnë shumë dhe mosmarrja e masave nga titullari, çon në neglizhencë në përmbushjen e detyrës ku dënohet sipas ligjit.

Dhënia e masave disiplinore janë në proporcion me shkeljet e kryera, pasi situatat e krijuara janë bërë si rezultat i mungesës së përgjegjshmërisë në punë. Dhe si rrjedhojë e shkeljeve të konsumuara prej saj, ajo ka marrë masa disiplinore të njëpasnjëshme.

11. Në lidhje me pretendimet e marrjeve të masave disiplinore kundrejt znj. L.S se ato “janë pakënaqësi personale me drejtoreshën e Spitalit Psikiatrik Vlorë, znj. M.M”, sqarojmë se ato janë konform Rregullores së brendshme të spitalit, “Detyrat e Drejtorisë së Spitalit”, në të cilën parashikohet si më poshtë:

- Programon punën për organizimin, drejtimin dhe kontrollin e shërbimit shëndetësor në Spitalin Psikiatrik të Vlorës (Neni 6, pika 1);
- Bën propozime dhe emërime të zv.drejtorëve dhe shefave të shërbimit të pavionëve sektorë (Neni 7, pika 3);
- Merr vendime për largime nga puna për shkelje të Kodit të Punës, kontratës dhe rregulloreve të shërbimit (Pika 10).

Gjithashtu, masat disiplinore janë bazuar në Udhëzimin Nr. 204, datë 09.04.2024 “Për procedurat e punësimit, emërimit, pezullimit, lirimit dhe të disiplinës për profesionet e shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë.

Më poshtë po japim disa shkelje të konsumuara prej saj, të cilat bien ndesh me aktet nënligjore që normojnë punën e mjekut:

- *Vihet re një diskriminim dhe përdorim i standardeve të dyfishta kundrejt pacientëve, pasi M.Xh nuk kishte të afërm që interesoheshin, dhe si e tillë nuk u morr asnjë masë për të zbardhur ngjarjen. Ndërkohë, po në pavionin kronik të grave, në Dhjetor 2023 (kur kjo mjeke ishte shefe pavioni) pacientja I.J ishte djegur në një rën këmbë me ujë, znj. L.S edhe pse atë periudhë ishte me leje të zakonshme, kërkoi me shkresë denoncimin e çështjes në organet kompetente. Arsye kjo sepse familjarët e pacientes interesohen, pra nuk është fokusiacienti sipas shefes në këtë rast, por frika e përhapjes së informacionit. (Bashkëlidhur kërkesa për dërgimin e çështjes në organet kompetente)*
- *Marrja e informacionit përmes ushtrimit të detyrës nga ana e znj. L.S dhe përdorimi i informacionit për shantazh ka krijuar stres dhe presion, ka qenë në mënyrë të vazhdueshme tek stafi. Konkretisht, në një mbledhje të mbajtur nga drejtoria, znj. L.S ka pranuar që ka filmuar mangësitë, të cilat i ka bërë për t'i mbajtur për vete. Nga ana e drejtorisë i është kërkuar të referojë problematikat që hasen, përndryshe ato nuk zgjidhen, gjë të cilën nuk e ka bërë në institucion. Shantazhi është një metodë e njohur për mjeken në fjalë, pasi edhe në videot e nxjerra prej saj në emisionin “Piranja”, ajo nuk është përpjekur si mjeke të ofrojë zgjidhje, por ka përdorur informacionin e marrë gjatë ushtrimit të detyrës për të ushtruar presion te drejtuesi i institucionit dhe te stafi.*
- *Regjistrime e incizime ka kryer tek kolegët ashtu siç ju jeni njohur që në fillim me këtë çështje duke sjellë si prova pranë Komisionerit regjistrime dhe filmime. Sipas dokumentacionit të shqyrtuar në dosjen personale, në tetor 2023 ka regjistruar Shefen e Personelit në administratë, madje duke e pranuar haptazi veprimin e kryer. Praktikë kjo e njohur prej mënyrës se si punonte në spital duke shantazhuar me regjistrues, administratë e personel. Gjithashtu, në dokumentacionin e ardhur nga Komisioneri është cituar se ka regjistruar Nën/Drejtorin Teknik z. S.T, pa asnjë motiv dhe të drejtë, duke shkelur edhe nenin 121 të Kodit Penal. (Bashkëlidhur gjeni kërkesën për marrje masash nga ana e Drejtorisë)*

Ankuesja pretendon se edhe nga ana personave të tjerë janë lejuar shkelje profesionale në fushën profesionale. Pikërisht këtu qëndron thelbi i çështjes, sepse nuk është kompetencë e znj. L.S që të përcaktojë shkeljet profesionale në fushën e mjekimit, por është Urdhri i Mjekut organi kompetent për shkeljet në fushën e profesionit në mjekësi, të cilat analizohen dhe diskutohen sipas procedurave të përcaktuara në ligjin specifik. Pra, nuk mundet që te tagrat ligjorë të Urdhrit të Mjekut, i cili është ent publik i pavarur, të angazhohemi ne si punëdhënës për marrëdhëniet që lidhen me kontratën e punës.

Në vitin 2023 një mjeke tjetër është trajtuar me masë disiplinore, ku për ironi ka qenë përplasja që ka patur me znj. L.S, tregues që ka shumë dritë-hije në raportet e punës me kolegët. (Bashkëlidhur masa disiplinore N.V)

Në tetor 2023 nga ana e mjekes psikiatre D.B ka një ankesë të detajuar mbi punën e znj. L.S në pavionin kronik, për sa i përket mbrojtjes dhe ofrimit të shërbimit ndaj pacientit psikiatrik (Bashkëlidhur ankesa e znj. D.B).

Ndërsa lidhur me mënyrën e drejtimit të institucionit nga ana ime si drejtuese, Ju sjell në vëmendje raportet e Avokatit të Popullit në dy vitet e fundit, dhe konkretisht:

Raporti krahasues i Avokatit të Popullit i bërë në vitin 2023 (periudhë në të cilën nuk kam qenë drejtuese e institucionit) dhe ai i bërë në vitin 2024 janë katërcipërisht të ndryshëm, shumë herë më shumë i përmirësuar dhe pa rekomandime urgjente. Kjo tregon përkushtimin dhe korrektesën time në drejtimin e institucionit.

Drejtorja e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë i qëndron pretendimit se, masat disiplinore të dhëna znj. L.S lidhen vetëm me shkelje të përsëritura gjatë ushtrimit të detyrës, dhe jo për shkaqe diskriminimi. Mosveprimi do të çonte në dëme fatale humbje në njerëz për shkak të papërgjegjshmërisë së shprehur në këtë hark kohor. Psikiatria nuk është shërbim shëndetësor ku mund të shprehet secili në mënyrë anarkie, angazhimi në këtë profil kërkon durim dhe bashkëpunim, por mbi të gjitha një nivel të lartë përgjegjshmërie”.

Në vijim, përfaqësuesit e ankueses, me shkresat e protokolluara me tonën me nr. 894/12 dhe nr. 894/13, datë 12.11.2024, në mes të tjerash kanë informuar se:

- 1. “Referuar objektit të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, çmojmë se ndaj ankueses znj. L.S me marrjen e masës disiplinore ndërprerje e marrëdhënieve të punës, është kryer diskriminim nga ana e Spitalit Psikiatrik Vlorë, përfaqësuar nga znj. M.M, diskriminim “për çdo shkak tjetër”.*
- 2. Spitali parashtron (fq. 2, par 2), masat disiplinore të mëparshme të marra ndaj znj. L.S për të prezantuar këtë të fundit si problematike për të justifikuar vendimmarrjen e saj. Ndërkohë, znj. L.S është e emëruar që në datë 29.09.2017, me Urdhrin nr. 239, si Shefe e Shërbimit Kronik dhe të gjitha masat që referon spitali se janë marrë ndaj saj (pavarësisht faktit nëse kanë qenë të drejta ose jo) nuk i kanë kushtuar, jo vetëm vendin e punës, por as edhe postin e Shefes së Shërbimit Kronik.*
- 3. Pra, këto masa (të shuara) që sipas spitalit “janë aq shumë në numër sa tregojnë problematikat e znj. L.S”, nuk kanë ndikuar jo vetëm për ta vendosur znj. L.S si kryetare në komisionin për arredimin e shtëpizave të mbrojtura por, as edhe në vlerësimet (maksimale) që i janë dhënë. Masa këto që përdoren tashmë si mjet ndikimi pranë KMD-së për të justifikuar vendimmarrjen e saj.*
- 4. Ndërkohë, ky raport vlerësimi maksimal i bërë ndaj znj. L.S është kryer brenda një kohe në të cilën, në spital kanë qenë si drejtuesja aktuale (e cila është emëruar në 03.11.2023) ashtu edhe drejtuesja e mëparshme znj. O.G.*
- 5. Gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesit e Spitalit kanë vijuar me akuza të pabazuara në prova ndaj znj. L.S, duke u përpjekur të përligjin si të bazuar ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, duke sjellë akte shkresore të cilave nuk iu janë referuar në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, duke e kthyer këtë seancë në një zgjatim të sjelljeve e qëndrimeve me sfond diskriminues. Në vijim duke mbajtur qëndrim selektiv dhe jo ligjor, nuk kanë përmbushur detyrimin për të depozituar provat e kërkuara nga KMD-ja dhe pala ankuese (kartela e z.U.A datë 14.08.2019), por referojnë dhe interpretojnë vetëm “prova” të cilat rëndojnë pozitën e*

ankueses, duke vijuar t'a denigrojnë ankuesen, duke e shfaqur edhe si person me probleme të shëndetit mendor. Doktore Znj. L.S për shkak të problemeve fizike ka kryer disa ndërhyrje kirurgjikale ndër vite (bashkëlidhur aktet), ndërhyrja e fundit ka qënë në shtyllën kurrizore në vitin 2017. Për këtë arsye ka kërkuar paaftësi të përkohshme në punë (invaliditet i pjesëshëm, të punojë gjashtë orë), kërkesë e cila nuk është pranuar nga ISSH Vlorë. Pala e akuzuar në vijim, në qëndrimet hakmarrëse dhe diskriminuese ka shkelur jo vetëm dispozitat ligjore, por edhe parimet e humanizmit, jo vetëm duke shpifur mbi gjëndjen mendore të ankueses dhe duke mos marrë në konsideratë faktin se ankuesja është e brishtë fizikisht, por duke mos marrë në konsideratë faktin se ankuesja është “e ve” dhe ka dy fëmijë nga të cilët vajza I.V është e mitur dhe në proces edukativ (bashkëlidhur aktet).

6. Në të kundërt nga sa është pretenduar nga Spitali se për rastet konkrete nga ana e znj. L.S janë shkelur Protokollat Mjekësore, Kodi Etikës dhe Deontologjisë, Rregullore e Brendshme e Spitalit, Kontrata individuale e punës, Ligji “Për Shëndetin Mendor”, dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore, vërtetohet në mënyrë të pakundërshtueshme se jo vetëm nuk ka kryer asnjë shkelje, por e ka kryer detyrën me përkushtim, bazuar në vlera të larta morale dhe etike si edhe në betimin e Hipokratit.
7. Vetë përfaqësuesit e Spitalit në deklaratimet e dhëna në seancën dëgjimore pohuan faktin se dinamika e punës në spital ka krijuar në të shkuarën problematika të të njëjtit nivel, por të cilat janë zgjidhur me mirëkuptim, duke vërtetuar në këtë mënyrë se në rastin konkret ndërprerja e marrëdhënieve të punës, është masë ndëshkimore ndaj znj. L.S nga ana e titullarit, në shenjë hakmarrje, pikërisht për shkaqet parimore që kemi parashtruar dhe në këto rrethana përbën diskriminim.
8. Znj. L.S në referim të nenit 4 të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, gëzon legjitimitetin aktiv në ushtrimin e ankesës. Në cilësinë e punëmarrësit ka lidhur kontratën me Spitalin Psikiatrik Vlorë.
9. Shkaqet diskriminuese ndaj znj. L.S: - Përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar detyrën e mjekes psikiatre dhe atë të Shefes së Shërbimit Kronik në spital, znj. L.S ka mbajtur qëndrim parimor, jo vetëm duke zbatuar aktet ligjore dhe nënligjore, por duke vënë në dukje në organet eprorë problematikën e këtij Spitali, me qëllim mbrojtjen e të drejtave të të sëmurve mendorë. Në ushtrimin e detyrës si mjekë psikiatre dhe artikullimin e problemeve të mirëfunksionimit të shërbimit kronik të këtij spitali, ka hasur në mospërfillje, në veprime dhe qëndrime arbitrare dhe antiligjore të drejtueses të insitucionit. Pikërisht dhe vetëm për këtë shkak ka nisur diskriminimi nga punëdhënësi, i përfaqësuar nga znj. M.M. Më parë marrëdhënia midis znj. L.S dhe znj. M.M ka qënë e mirë, e bazuar në respektin reciprok dhe në hierarkinë e vendit të punës. Kjo vërtetohet nga komunikimet e ndërsjellta të fiksuara në telefonin e ankueses, komunikime të nisura në datë 22.11.2023 dhe të cilat vijnë deri në datë 10.01.2024, datë e cila përkon me refuzimin e znj. L.S për të nënshkruar dokumentin me titull “Lista e çmimeve për arredimin e shtëpizave të mbështetura”.
10. Po në datë 10.01.2024, pas takimit që është bërë me personelin në ambientet e pavionit kronik/gra për nxjerrjen e përgjegjësve për një incident të ndodhur në këtë pavion, znj. L.S verbalisht i ka kërkuar znj. M.M marrjen e masave ndëshkuese për personat përgjegjës, por

- ka hasur në mospërfilljen e drejtueses. Në datë 10.01.2024, ora 19.25 në rrethanat kur ka konstatuar se Drejtoresha e Institucionit personave përgjegjës të incidentit iu kishte dhënë lejen e zakonshme duke i favorizuar, nëpërmjet komunikimit telefonik me sms, i është drejtuar znj. M.M në cilësinë e Drejtores, duke i kërkuar të zbatojë ligjin, të nisë hetimin disiplinor për personat përgjegjës të faktit të cituar më sipër, në të kundërt do të informonte Avokatin e Popullit dhe Ministrin e Shëndetësisë.
11. Nëpërmjet relacionit nr. 88, datë 11.01.2024 drejtuar Spitalit, znj. L.S ka identifikuar përgjegjësit për djegien e këmbës së pacientes I.J dhe i ka kërkuar drejtores t'i drejtohet organeve të zbatimit të ligjit për të hetuar rastin.
 12. Me shkresën nr. 136, datë 16.01.2024; shkresën e datës 23.01.2024; shkresën nr. 224, datë 26.01.2024; pasi është informuar nga personeli vartës se ndaj tyre nga ana e Drejtorisë së Spitalit janë marrë masa disiplinore në grup, i ka kërkuar znj. M.M informacion mbi masat disiplinore të marra ndaj punonjësve në lidhje me indicientin e djegies së pacientit si edhe bazën ligjore. Kërkesa këto të dërguara edhe në format elektronik “e-mail” zyrtar. Nëpërmjet komunikimit elektronik “e-mail” znj. M.M refuzon ta informojë me arsyetimin se “...në respektim të parimit të privatësisë dhe konfidencialitetit dosja është personale...”.
 13. Me shkresën e datës 12.02.2024 i ka kërkuar znj. M.M argumentet dhe bazën ligjore të urdhrit nr. 68, datë 09.02.2024, për transferimin e personelit mjekësor në varësi të znj. L.S, pa propozimin e shefit të shërbimit (neni 17 i rregullores së brendshme të spitalit), transferim i cili është kryer në kundërshtim me procedurën dhe ka sjellë si pasojë uljen e cilësisë së shërbimit ndaj pacientëve të pavionit kronik-burra, ku znj. L.S ishte shefe e shërbimit. Referuar Rregullores së Brendshme të Spitalit, Neni 7 “Detyrat dhe kompetencat e drejtorit të spitalit psikiatrik”, titullari nuk ka të drejtën të transferojë pa propozimin e shefit të shërbimit personelin e mesëm.
 14. Në datë 14.02.2024 nëpërmjet komunikimit elektronik, sms, i është drejtuar z. Lorenc Rexho, Drejtor i OSHKSH Vlorë, të cilit i ka referuar veprime dhe qëndrime të Drejtorit të Spitalit znj. M.M, në lidhje me injorimin e kërkesave të znj. L.S në kuadër të përgjegjshmërisë në ushtrimin e detyrave, me pasojë uljen e cilësisë së shërbimit ndaj pacientëve, por nuk ka marrë përgjigje prej tij. Asnjë nga kërkesat e parashtruara nga znj. L.S, nga ana e punëdhënësit znj. M.M nuk është marrë në konsideratë.
 15. Pasi në datë 11.01.2024 ka ndërprerë edhe çdo komunikim verbal me ankuesen, znj. M.M ka vendosur ta ndëshkojë dhe të hakmerret. Për të realizuar hakmarrjen ndaj ankueses, nga pala e akuzuar është vepruar me plan të mirëmenduar dhe afatgjatë, i cili ka synuar dhënien e përsëritur të disa masave disiplinore ndaj ankueses, me qëllim që të përligjej ndërprerja e marrëdhënieve të punës sipas kërkesave formale si gjoja e bazuar në ligj. Për këtë arsye duhej të gjendeshin “shkaqe të besueshme” për marrjen e masave disiplinore. Në vijim shtjellojmë faktet e pretenduara si shkaqe të besueshme dhe të cilat u evidentuan si shkelje mbi bazën e të cilave spitali ka dhënë masat disiplinore ndaj znj. L.S si dhe procedura e zgjidhjes së kontratës:
 16. Episodi i parë: Në datë 27.02.2024, në orën 17.00, në kohën që znj. L.S ka qenë në detyrën e mjekes së rojës është paraqitur në pranimi pacienti S.L me diagnozë “post dehje alkoolike, të shoqëruar me çrregullime të sjelljes”. Doktoreshë znj. L.S e ka mbajtur në observacion për

trajtim të mëtejshëm. Në lidhje me protokollin e trajtimit të këtij pacienti kanë lindur kontradikta me shefen e shërbimit akut znj. E.Sh.

17. Tendenca për marrjen e masave ndaj znj. L.S për shkak të pakënaqësisë që ka krijuar evidentohet edhe nga fakti që, jo vetëm spitali nuk ka marrë ndonjë masë ndaj mjekëve që kanë pranuar pacient nën ndikimin e drogës dhe alkoolit, masë nuk është marrë as edhe kur Dr. Eralda Myslimi në datë 14.08.2019, ka shkruar në kartelën e pacientit Ulsi Agaj që pacientit ti jepet alkol (raki) i pijshëm. Kohë kjo në të cilën Shefe e Shërbimit Akut ka qenë gjithashtu znj. E.Sh. (Thënë kjo edhe në seancën dëgjimore të datës 09.10.2024, ora 01:44:32 deri në 01:46:02). Nga ana jonë ju është vënë në dispozicion ky fakt nga kartela e pacientit më sipër dhe ja keni lënë gjithashtu si detyrë spitalit që t'ju sjelli edhe kartelën e tij. Kartelë të cilën nuk rezulton të jetë sjellë.
18. Në datë 01.03.2024, në orën 13.00 është organizuar mbledhje e stafit mjekësor, në të cilën nuk ka qenë e pranishme për arsye objektive. Referuar komunikimeve telefonike, nga nëndrejtori Teknik z. Stilian Lepuri ka marrë njoftimin se mbledhja ishte anuluar, por në fakt mbledhja është organizuar pa praninë e saj dhe tematika e mbledhjes kanë qenë veprimet e doktorëshë Selimaj në ushtrimin e detyrës si mjekë roje në datë 27.02.2024. Në këtë mbledhje nga ana e mjekëve të pranishëm është dalë në përfundimin se:- a) ka shkelur protokollin mjekësor të diagnostikimit dhe mjekimit të pacientit S.L si dhe b) shkelje të etikës profesionale dhe në këto rrethana nga mjekët është përpiluar dhe nënshkruar një relacion drejtuar Drejtorit të Institucionit znj. M.M.
19. Në datën 05.03.2024, në ambientet e spitalit, është organizuar një tjetër mbledhje e mjekëve të spitalit, ku përsëri për arsye objektive nuk ka qenë e mundur të marrë pjesë dhe për këtë fakt ka njoftuar eprorët. Edhe në këtë rast ka qenë në padijeni të tematikës së takimit dhe të konkluzioneve të mbledhjes. Verbalisht, nga komunikimi me personelin e mesëm të spitalit, është informuar se ndaj saj ishin marrë masa administrative. E gjendur në këtë situatë, i është drejtuar insitucionit me shkresë zyrtare “Kërkesë” e datës 11.03.2024 për të vënë në dispozicion këto akte. Kjo kërkesë është administruar me nr. 686, datë 12.03.2024. Ka disponuar dy akte përkatësisht: Aktin me titull: “Relacion” nr. 596, datë 01.03.2024, drejtuar Drejtorisë së Spitalit, nënshkruar nga 6 mjekë, si edhe akti me titull “Procesverbal” mbi mbledhjen e zhvilluar në datë 05.03.2024, me nr. 632, datë 06.03.2024. Në datë 11.03.2024 është thirrur nga shefe e personelit dhe i ka dorëzuar dy akte. Shkresë me nr. 649, datë 07.03.2024, me titull: “Masë disiplinore”, punonjëses znj. L.S, ku konkludohet me “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”; “Urdhër” nr. 101, datë 11.03.2024: “Për lirim nga detyra të Shefes së Shërbimit kronik Burra-Gra znj. L.S”, protokolluar me nr. 676, datë 11.03.2024.
20. Analiza ligjore:- Emetimi i akteve të mësipërme nga ana e institucionit, është bërë duke shkelur dispozitat e Kodit të Punës, duke shkelur parimet e Ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; Ligjit Nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar; Ligji 44/2012 “Për shëndetin mendor”, i ndryshuar; “Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore”; “Protokoll i kujdesit diagnostik dhe terapeutik për pacientin e axhituar”; “Rregullore e Brendshme e Spitalit Psikiatrik” Vlorë, akte ligjore

dhe nënligjore të cilat sanksionojnë të drejtat dhe detyrat si edhe garantojnë proces të rregullt ligjor. Nga analiza e akteve të sipërcituara konstatohet se megjithëse në këtë rast nuk është kryer hetim disiplinor sipas kërkesave të ligjit, ndaj znj. L.S në kundërshtim me ligjin janë marrë masa disiplinore me karakter haptas ndëshkimor. Punëdhënësi Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, përfaqësuar nga Znj. M.M nuk ka kompetencën lëndore për hetimin dhe marrjen e masës ndaj saj. Në hetimin e rastit në fjalë parimisht duhet të ndiqej kjo procedurë; a) hetimi disiplinor duhet të iniciohej nga subjekti i dëmtuar/cënuar ose çdo subjekt tjetër i interesuar nëpërmjet kërkesës për fillimin e hetimit disiplinor; b) duhet të identifikohet organi publik i cili gëzon legjitimitetin e kryerjes së hetimit disiplinor; c) Nëse do të finalizohet me vendim i cili konstatonte shkelje konkrete nga ana e një organi publik i cili nuk është punëdhënësi, punëdhënësi do të identifikonte shkeljen e konstatuar nga organi tjetër publik, duke e vlerësuar këtë shkelje në raport me detyrimet të cilat punëmarrësit i burojnë nga kontrata individuale e punës dhe nga punëdhënësi do të çmohej nëse do të vijohej sipas përcaktimeve të nenit 37 të Kodit të Punës, pra gjithnjë nëse shkelja konkrete ishte parashikuar njëkohësisht edhe në kontratën e punës.

21. Në rastin konkret sipas përmbajtjes së aktit me titull “Relacion”, rezulton se iniciatorët e fillimit të hetimit disiplinor ndaj znj. L.S janë mjekët e Spitalit, të cilët në mbledhje, pa praninë e saj, kanë diskutuar dhe konkluduar për: a) shkelje të protokollit mjekësor të diagnostikimit dhe mjekimit në shërbimet e shëndetit mendor si edhe; b) çështjes të shkeljes së etikës profesionale, relacion i përcjellë tek drejtoresha e institucionit.
22. Në vijim, në datë 05.03.2024, të njëjtët mjekë kanë organizuar një tjetër mbledhje, e cila ka pasur si objekt analizën e relacionit të përpiluar prej tyre në datë 01.03.2024, nr. 596, relacion i hartuar dhe drejtuar drejtores së institucionit. Përgjatë kësaj mbledhje, dokumentuar në procesverbal, rezulton se nga ana e mjekëve janë shprehur konsiderata personale, janë uzurpuar kompetenca, duke shkelur haptas parimet të cilat normohen në Ligjin 123/2014 “Për urdhrin e mjekëve”. Kështu ata janë shprehur se doktoreshë Znj. L.S ka paaftësi profesionale, shkel protokollin, rrezikon jetën e pacientëve si edhe jepet sugjerimi që të largohet nga shefe e shërbimit kronik (pa evidentuar se në çfarë mënyre e ka rrezikuar jetën e pacientëve dhe cila është pasoja konkrete mbi të cilën kanë konkluduar se është rrezikuar jeta e pacientëve). Po në këtë takim në kundërshtim me çdo procedurë ligjore propozohet nga mjekët të ndërmerrej masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna” si edhe “të hiqej nga shefe e shërbimit kronik”.
23. Nga ana e Drejtores së institucionit znj. M.M, duke e shfrytëzuar këtë situatë të krijuar, janë emetuar aktet “Masë disiplinore” pra “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, nr. 649, datë 07.03.2024 dhe akti me titull: “Urdhër” nr. 101, datë 11.03.2024 “Për lirimin nga detyra të Shefes së Shërbimit kronik Burra-Gra të znj. L.S, të cilat janë ekzekutuar.
24. Masa disiplinore “vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra”, është e paligjshme jo vetëm sepse fakti konkret për të cilin është marrë masa në thelb nuk përbën shkelje disiplinore sipas kontratës së punës apo shkelje sipas ndonjë akti tjetër ligjor ose nënligjor⁷, por edhe

⁷ Kreu VII, pika 2: “Shkeljet disiplinore, si rregull përcaktohen në kontratën kolektive të punës, si dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi” i Udhëzimit nr. 205, datë 9.4.2024 “Për procedurat e punësimit, emërimit, pezullimit, lirimit dhe të disiplinës së

sepse punëdhënësi, nuk e ka garantuar punëmarrësin me respektimin e procedurës për marrjen e masës disiplinore. Siç u theksua dhe provohet, të dyja mbledhjet janë mbajtur në mungesë të znj. L.S dhe kjo e fundit nuk është njoftuar në lidhje me fillimin e procedimit disiplinor ndaj saj dhe të drejtën e saj për t'u dëgjuar, si me anë të dhënies së sqarimeve paraprake, ashtu edhe gjatë shqyrtimit të çështjes.

25. Sikurse u theksua në rastin konkret ka shkelje ligjore në lidhje me organin publik që kryen hetimin disiplinor, i cili në rastin konkret nuk legjitimohet të jetë punëdhënësi për arsyet si vijojnë: - Në ushtrimin e detyrës mjeku psikiatër zbaton për pacientët të cilët pranon në spital procedurat e përcaktuara në aktin më titull: “Protokoll i kujdesit diagnostik dhe terapeutik për pacientin e axhituar”, si edhe dispozitat e “Kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore”. Nga përmbajtja e aktit me titull “Relacion”, konstatohet se organi i cili duhet të kryente hetimin disiplinor në lidhje me pretendimet për shkelje të “Protokollit të Kujdesit Diagnostik dhe Terapeutik për pacientin e axhituar” duhet të ishte Këshilli Rajonal i Urdhrit të Mjekut Vlorë dhe Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Mjekut. Po kështu edhe në lidhje me pretendimet se ka shkelur rregullat e “Kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore”, kompetent është po ky organ. Kështu në nenin 68 të “Kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore” përcaktohet se: “Çdo akt mjekësor, apo sjellje profesionale në kundërvajtje të dispozitave të këtij kodi, përbën objekt për ndjekje dhe gjykim disiplinor profesional bazuar në Ligjin nr. 8615, datë 01.06.2000 “Për urdhrin e mjekëve”, i ndryshuar, dhe në “Rregulloren e gjyimit Profesional të Urdhrit të Mjekëve”.
26. Referuar kontratës individuale të punës, znj. L.S në asnjë nga dispozitat e saj nuk specifikohet si kusht pa të cilin mund të sillte pasoja për punëmarrësin në marrëdhëniet e punës, (përveç nenit 17 germa “dh” të Ligjit Për urdhrin e Mjekut) shkelja e protokollit mjekësor dhe kodit të etikës dhe deontologjisë edhe sikur masa disiplinore të ishte marrë nga Urdhri i Mjekut. Kështu në nenin 7 të kontratës individuale përcaktohet se: “Punëmarrësi ka për detyrë të zbatojë orarin e punës, të mirëmbajë vendin e punës dhe dokumentet përkatëse, të mos lërë në mënyrë të pajustificuar vendin e punës dhe të zbatojë dispozitat në fuqi për marrëdhëniet e punës”.
27. Duke iu rikthyer çështjes nga mjekët e Spitalit i janë relatuar punëdhënësit shkelje nga ana e znj. L.S dhe është propozuar të iniciohet një hetim disiplinor me pretendimin e shkeljes se protokollit mjekësor dhe etikës profesionale, dhe titullare e institucionit nga ana e vet edhe pse në mungesë të kompetencës për shqyrtimin e rastit, pa procedurë ligjore ka ndërmarrë sanksione. Nga ana tjetër nga mjekët janë shkelur detyrimet e përcaktuara në nenin 10 të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë: “Mjekët kanë për detyrë të mbajnë marrëdhënie të mira me njëri tjetrin dhe me anëtarët e tjerë të personalit mjekësor, duke respektuar pavarësinë profesionale të secilit, në interes të të sëmurëve dhe ruajtjes së emrit të mirë të profesionit dhe të institucionit mjekësor”, neni 42 Respekti reciprok. Mjekët sipas këtij kodi të etikës kanë liri dhe pavarësi profesionale edhe në procedurat e diagnostikimit e mjekimit të të sëmurëve.

28. *Nga ana e punëdhënësit është deklaruar në seancë dëgjimore se në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” nuk janë pranuar kurrë në mënyrë kategorike dhe nuk janë trajtuar persona të alkolizuar dhe se nga ana e daktoreshë znj. L.S është kryer një shkellje shumë e rëndë duke rrezikuar jetën e pacientit S.L, pasi ka përdorur pije alkolike (raki) si medikament për trajtimin. Këto pohime nuk janë të vërteta dhe kanë si qëllim të ndikojnë dhe të rëndojnë në mënyrë të padrejtë pozitën e ankueses përpara KMD si edhe të përlligjin masat e marra ndaj saj në kundërshtim me ligjin. Nga provat të cilat janë administruar është vërtetuar se në këtë spital janë pranuar në observim dhe trajtuar persona në gjendje dehje alkolike.*
29. *Episodi i dytë. Rrethanat e faktit: Në datë 31.03.2024 është paraqitur në pranim paciente M.Sh, me diagnozë “çrregullim bipolar I, episod maniakal në person, grvide 32 javëshe”, (shtatzënë), të cilën mjeke psikiatre Znj. L.S e shtroi urgjent.*
30. *Në datë 22.04.2024 bëhet konsultë e përgjithshme ku vendoset se pacientja sapo të hyjë në muajin e nëntë të bëjë konsultë gjinekologu dhe të planifikohet lindja nën asistencën e gjinekologut dhe psikiatrit dhe në datë 14.05.2024 planifikohet lindja cezariane në spitalin obsetrik Vlorë, e cila do të kryhej në datë 24.05.2024, ku asistencë e mjekes kuruese psikiatre Znj. L.S ishte e detyrueshme. Sa më sipër është evidentuar në kartelën klinike dhe i është referuar shefes së shërbimit akut me shkrim në kartelë.*
31. *Në datë 24.05.2024, ndërkohë që ishte në shërbim në Spitalin Psikiatrik Vlorë, është thirrur në drejtori nga znj. M.M e cila i ka komunikuar se kishte braktisur vendin e shërbimit dhe në prani të sekretares është mbajtur procesverbal, pra bëhet fjalë për periudhën kohore ora 08.00 deri në orën 11.10, të datës 24.05.2024, orë në të cilën është rikthyer në spital në detyrë.*
32. *Në datë 28.05.2024 shefe e personelit i ka dorëzuar shkresën me nr. 1233, datë 27.05.2024 me titull: “Masë disiplinore Vërejtje”. Arsyeimi ligjor në lidhje me shkeljet ligjore të konstatuara në marrjen e masës disiplinore: Për shkak të kësaj mungese nga shërbimi prej 3 orësh për të asistuar pacienten M.Sh për të lindur në datë 27.05.2024, punëdhënësi ka filluar hetim disiplinor për shkelje e cila rregullohet nga marrëdhëniet e punës e konkretisht kontrata individuale, për braktisje të vendit të punës dhe ndaj znj. L.S është marrë masa tjetër disiplinore “vërejtje”.*
33. *Edhe në lidhje me këtë masë, Drejtoresha znj. M.M nuk ka garantuar znj. L.S me respektimin e procedurës sepse në thelb, realisht nuk është dëgjuar. Kjo pasi, ndërsa nga ana e znj. L.S u pretendua fakti i njoftimit të Shefave të Shërbimit dhe, nga ana e Shefave të Shërbimit që znj. L.S nuk i kishte njoftuar - ndërkohë që pacientët prisnin për disa orë-ka vendosur të pranojë pretendimet e Shefave të cilët kishin motiv të pretendonin të kundërtën për t’ju shmangur përgjegjësisë pasi, në nenin 17.10 § 17.12 § 17.13 §18.5 § 33.1 i Urdhrit Nr. 11, datë 10.10.2013 “Për miratimin e rregullores së brendshme të Spitalit Psikiatrik Ali Mihali Vlorë” janë parashikuar edhe detyrat që kanë Shefat e Shërbimit dhe që lidhen me faktin se duhet të dinë çfarë bëhet në institucion për shkak edhe të pozicionit që ata mbajnë. Kështu, në këtë nen është parashikuar se: -“Detyrat dhe kompetencat e shefit të shërbimit janë Bashkëpunon dhe bashkërendon punën me shërbimet e tjera që... Kontrollon kartelat e të sëmurëve... Një herë në javë bën vizitë të përbashkët me shefat e repartit dhe mjek kurues... shefi i shërbimit bënë grafikun e rojeve”. Grafiku i rojeve gjithashtu është i shpallur në ambientin e konsultave*

psikiatrike pikërisht për këtë arsye, që në çdo rast të mund dihet ky fakt që të mund të merren paraprakisht masat organizative sipas rastit.

34. Në rastin konkret trajtimi që i është bërë znj. L.S në raport me Shefat e Shërbimit nuk është i drejtë sepse sipas parashikimeve ligjore më sipër, presumohet që Shefat e Shërbimit janë në dijeni të mungesës së znj. L.S, dhe fakti që pacientët prisnin për disa orë për të bërë vizitat nuk ka ardhur për shkak të ndonjë faji të znj. L.S që kishte vajtur me detyrë të planifikuar në datë 24.05.2024 në Spitalin Rajonal Vlorë, por është për shkak të Shefave të Shërbimit që kanë neglizhuar të përmbushin detyrat e tyre në organizimin e duhur të punës në institucion. Ky fakt u pohua edhe nga shefe e shërbimit akut znj. E.Sh gjatë seancës dëgjimore, e cila deklaroi se nuk mund të kontrollonte gjithë kartelat e pacientëve, duke kundërshtuar deklaratimet e mëparshme ku këmbënguli se kontrollon çdo kartelë pacienti dhe se mjekët kanë detyrë të komunikojnë me të për çdo pacient. Ky qëndrim kontradiktor kishte si synim shkarkimin nga përgjegjësia disiplinore për mosmarrjen e masave për mbulimin e shërbimit në urgjencë në datë 24.05.2024. Në rastin konkret qartazi konkludohet se fakti i mungesës së mjekes znj. L.S nuk përbën shkelje disiplinore dhe se nga ana e doktorëshë znj. L.S nuk është kryer asnjë veprim në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, por kjo nuk e ka penguar znj. M.M të vijojë me projektin e saj hakmarrës për dhënien e një tjetër mase disiplinore.
35. Në rastin konkret edhe pse fakti nuk përbën shkak për fillimin e ecures disiplinore, çmujmë se është shkelur jo vetëm procedura në lidhje me kompetencën e organit që shqyrton shkeljen e pretenduar, por edhe ajo e cila normon sjelljen e organit, nëse vërtet do të kishte kompetencën për të shqyrtuar hetimin konkret disiplinor. Kështu punëdhënësi, nuk e ka garantuar punëmarrësin me respektimin e procedurës për marrjen e masës disiplinore për faktin që pretendon se përbën shkelje disiplinore sipas nenit 37.2 të Kodit të Punës. Duke qënë se mungesa e znj. L.S ishte e planifikuar në konsulta mjeksore, e evidentuar në kartelën klinike, ky largim përbën sjellje profesionale e diktuar nga rrethana konkrete që lidhen me procedurën në lindje të pacientes M.SH, paciente e cila lindi në datë 24.05.2024 në spitalin Obstetrik Vlorë, në asistencën si pjesë e ekipit mjeksor edhe të psikiatres znj. L.S, fakt i pohuar nga shefi i shërbimit, mjeku obstetër gjinekolog z. B.Z me deklaratën noteriale nr. 2661, datë 23.10.2024. Pra “braktisja e vendit të shërbimit” në rastin konkret duhet të referohet pranë Urdhrit të Mjekut me qëllim hetimin disiplinor, nëse vërtet do të ekzistonte, por në fakt nuk ka ndodhur.
36. Episodi i tretë: Në datë 24.05.2024 është paraqitur në urgjencë pacienti R.V me diagnozë “çrregullim personaliteti, me periudha dekompesimi psikotik në person që ka abuzuar në substancë cannabiss sattiva, heroinë”.
37. Në datë 27.05.2024 është konstatuar nga mjekë znj. L.S se pacienti veç probleme psikike, kishte shfaqur probleme dermatologjike (parazitozë-ngjitëse) të cilat kërkonin asistencën e një mjeku specialist të Spitalit Rajonal Vlorë. Në këto rrethana, pasi bëri analizën e riskut të pacientit, të cilën e ka evidentuar në kartelën e pacientit dhe ka çmuar se pacienti nuk paraqiste rrezikshmëri të lartë sipas standardeve që mjeku çmon rast pas rasti, ka urdhëruar kryeinfermierin e pavionit të organizonte transportin e pacientit tek mjeku përkatës dhe kështu

- është vepruar. Pasi pacienti ka marrë asistencën mjekësore, në kthim për spital është konfliktuar me drejtuesin e ambulancës së transportit dhe kujdestarin i cili e shoqëronte.
38. Në datë 29.05.2024 u organizua mbledhje e Këshillit Teknik Mjekësor, e pasqyruar në procesverbalin përkatës dhe mjekët përpiluan një relacion me nr. 1254, të cilin e dorëzuan në zyrën e Drejtorit të Institucionit, znj. M.M, akt në të cilën kanë shprehur gjykime profesionale në lidhje me rastin. Kolegët kanë fajësuar mjeken psikiatre znj. Laureta në lidhje me analizën e riskut për këtë pacient, pasi sipas mendimit të shprehur prej tyre nga doktoresha nuk është vlerësuar sa duhet rrezikshmëria e pacientit. Në fakt në mbledhjen e organizuar në datë 27.05.2024, menjëherë pas incidentit, për të cilën është mbajtur procesverbali përkatës, mbledhje në të cilën znj. L.S u thirr me cilësinë e mjekut kurues të pacientit, nga mjekët e pranishëm dhe shefja e shërbimit akut znj. E.Sh faji për ngjarjen iu atribua kujdestarit shoqëruar z. E.M, si person i patrajnuar në shërbim të të sëmurëve mendorë dhe ndaj tij u mor masë disiplinore duke u pezulluar nga detyra. Por në vijim çuditërisht sikurse u citua më lart, u rimblodhën duke përpiluar relacionin sipas të cilit mjekja nuk kishte bërë analizë të riskut të pacientit, fakt i cili nuk ishte i vërtetë. Në vijim të sjelljeve agresive dhe diskriminuese, por edhe jologjore mjekët kanë shkelur nenin 10 të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë sipas të cilit: “Mjekët kanë për detyrë të mbajnë marrëdhënie të mira me njëri tjetrin dhe me anëtarët e tjerë të personalit mjekësor, duke respektuar pavarësinë profesionale të secilit, në interes të të sëmurëve dhe ruajtjes së emrit të mirë të profesionit dhe të institucionit mjekësor”. Pavarësisht se në rastin konkret nuk u iniciua hetim disiplinor ndaj doktoreshë znj. L.S, aktet e përpiluara i janë referuar Ministrisë së Shëndetësisë me qëllim uljen dhe denigrimin e figurës nga ana profesionale duke plotësuar kështu një mozaik të tërë provash jo ligjore në seri, të cilat shërbyen si bazë për zgjidhjen e kontratës së punës nga ana e znj. M.M. Kështu në Urdhrin nr. 188, datë 30.05.2024 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të Punës”, citohet se si bazë për këtë vendim-marrje ka qenë edhe relacioni nr. 1254, datë 29.04.2024. Edhe ky episod duhet të relatohej pranë “Urdhrit të mjekut” me qëllim hetimin disiplinor për arsye se kanë bërë gjykime profesionale mbi analizën e riskut për pacientin i cili trajtohej nga mjeke psikiatre znj. L.S.
39. Ndaj znj. L.S është kryer diskriminim vetëm për shkaqe parimore, i cili shprehet qartë jo vetëm në përzgjedhjen e rasteve konkrete të cilat janë konsideruar shkelje, kur në fakt nuk janë të tilla, por edhe në procedurat për marrjen e masave disiplinore për të ashtuquajturat shkelje të cilat kishin synim final ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.
40. Në sjelljen dhe veprimet denigruese dhe diskriminuese ndaj ankueses, midis znj. M.M dhe vartësve ka pasur ndërveprim. Kështu, megjithëse në aktet të cilat i relacionin znj. M.M me cilësinë e Drejtorit të Institucionit, shprehnin konsiderata profesionale me përmbajtje fyese dhe denigruese, të cilat shkelnin kodin e Etikës dhe Deontologjisë si edhe propozime konkrete për masa disiplinore të rënda deri në largim nga puna. Drejtori i Institucionit, i cili është i diplomuar si Jurist, që nënkupton njohjen e akteve ligjore e nënligjore, jo vetëm nuk ka marrë masa për ndërprerjen e kësaj gjendje, por duke pasur synime hakmarrëse ka qenë vetë aktori kryesor i ushtrimit të diskriminimit, e materializuar në sjellje konkrete e ndërveprim fyese, aktet administrative ndëshkuese, të cilat kulmuan me zgjidhjen e kontratës së punës, zgjidhje kjo në

kundërshtim me çdo procedurë ligjore. Vërtetohet se midis tyre ka pasur dhe ka bashkëpunim në këtë veprimtari diskriminuese, në ndihmë të znj. M.M, bashkëpunim i cili diktohet nga marrëdhëniet e interesit në raportet epror-vartës.

41. Episodi IV: Në datë 29.04.2024 kolegët, “....shumë të indinjuar, të fyer dhe të shantazhuar si edhe të traumatizuar psikologjikisht nga intervista e dhënë në Top Albania Radio” paraqesin një Kërkesë Urgjente nr. 1042, datë 29.04.2024, këtë rast adresuar znj. A.K, Ministre e Shëndetësisë, Urdhrit të Mjekut, Avokatit të Popullit, Drejtorisë Rajonale të Kujdesit Shëndetësor, si edhe Drejtorit të Spitalit Psikiatrik Vlorë, e cila është pranuar në cilësinë e provës ku kërkohet të shqyrtohet rasti në fjalë dhe të merren masa urgjente mbi aftësinë profesionale, etikën, komunikimin me kolegët dhe eprorët. Në thelb kjo shkresë përbën një kërkesë për fillimin e hetimit disiplinor. Pasi kjo shkresë është administruar në Ministrinë e Shëndetësisë, Ministria e Shëndetësisë me shkresën Nr. gj/13/1, datë 27.05.2024 drejtuar DROSHKSH Vlorë, nëpërmjet të cilës sugjeron Drejtorinë e Spitalit Psikiatrik Vlorë, të marrë masa për shqyrtimin e problematikës sipas akteve ligjore dhe nënligjore. Pra edhe pse shkresa i është dërguar DROSHKSH-së Vlorë, kjo drejtori nuk ka vepruar, por është orientuar Spitali Psikiatrik Vlorë të marrë masa për shqyrtimin e problematikës dhe për hetimin disiplinor. Pas këtij momenti Drejtori i Spitalit, duke pretenduar se kjo shkresë përbën bazë ligjore për ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës, në datë 30.05.2024, ka emetuar Urdhër Nr. 188 “Për Ndërprerje të Marrëdhënieve të Punës”.
42. Këtë situatë ndaj mjekes psikiatre znj. L.S e paraprin një tjetër episod me sfond diskriminues. Pasi një kopje e “Kërkesës Urgjente” datë 29.04.2024 i ka mbërritur DROSHKSH Vlorë, në datë 30.04.2024, vetë Drejtori i këtij institucioni z. L.R mbërrin në psikiatri dhe organizohet mbledhje. Në mbledhjen e datës 30.04.2024, mbledhje në të cilën ka qenë i pranishëm dhe Drejtori Spitalit znj. M.M si edhe mjekët, është intimiduar, është atakuar në grup për paaftësi profesionale, për shkelje të protokolleve mjekësore të diagnostikimit dhe mjekimit si edhe çështje të shkeljes së etikës profesionale znj. L.S. Diskutimet në këtë takim janë regjistruar në audion sipas kërkesës së mjekëve dhe janë administruar me cilësinë e provës. Shkak i këtij takimi , ku edhe z. L.R ka qenë në unison me anëtarët e tjerë, ka qenë jo vetëm çfarë citohej në “Shkresën urgjente”, por edhe një intervistë të cilën e ka dhënë në Top Albania Radio, të cilën e kemi vëmë në dispozicion. Megjithëse sikurse mund të gjykohet dhe konstatohet lehtësisht nuk ka kryer asnjë shkelje dhe nuk ka fyer askënd, nuk ka cënuar integritetin e asnjë personi, nuk ka nxjerrë të dhëna sensitive apo me karakter personal, nuk ka denigruar institucionin apo persona të veçantë ndër ta edhe mjekët, por vetëm ka reklamuar faktin se i është drejtuar ligjit me qëllim mbrojtjen e të drejtave, kjo është konsideruar shkelje e rëndë dhe për këtë shkak është sulmuar në grup. Dukshëm dhe shumë qartë edhe një herë në këtë akt shkresor (“Kërkesë urgjente”) vërtetojnë diskriminimin koherent, për të cilin ritheksohet se megjithëse Drejtori i Institucionit znj. M.M ka qenë në dijeni, jo vetëm nuk ka marrë masa për ta parandaluar, por e ka dirigjuar derisa ka mbërritur në zgjidhjen e kontratës me pasoja shumë të rënda social-ekonomike dhe psikologjike për ankuesen”.

Në vijim përfaqësuesi i ankueses Av. Th.DH, me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 894/4, datë 13.12.2024, ka dërguar kopje të shkresës nr. 2541/3, datë 05.12.2024 të dërguar nga Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, në lidhje me protokollin dhe diagnozën e absitencës alkolike.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 12/1/c, ku përcaktohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ... c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”*, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, bazuar në çdo shkak tjetër, duke përfshirë këtu dhënien e masave disiplinore dhe zgjidhjen e kontratës së punës.

Bazuar në pikën 5, germa “c”, të nenit 9, të Kodit të Punës, parashikohet se: *“Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:..c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”*.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesin në të drejtën e tij për punësim, duke përfshirë këtu edhe momentin e përfundimit e marrëdhënieve të punës;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ankuesja i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e tij për punësim dhe më konkretisht në lidhje me zgjidhjen e kontratës së punës.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

Me shkresën nr. 226, datë 12.04.20207, znj. L.S është emëruar në pozicionin si mjeke psikiatre pranë Spitalit Psikiatrik Vlorë dhe mes palëve është lidhur kontrata e punës datë 12.04.2007.

Me Urdhrin nr. 239, datë 29.09.2017 *“Për lirim dhe emërim në detyrë”*, znj. L.S është emëruar në detyrën e Shefes së Shërbimit kronik në Spitalin Psikiatrik Vlorë.

Me Urdhrin nr. 664/1, datë 08.11.2023 *“Për emërimin e përkohshëm në detyrë të Drejtorit të Drejtorisë së Spitalit Psikiatrik Vlorë”*, znj. M.M është emëruar në detyrën e Drejtorit të Spitalit Psikiatrik Vlorë.

Me Urdhrin nr. 221, datë 20.11.2023 *“Për ngritjen e Komisionit për pajisje të shtëpizave të mbështetura”*, znj. L.S është emëruar si kryetare e këtij komisioni. Me Relacionet nr. 2127, datë 05.12.2023 dhe nr. 09/1, datë 04.01.2024, Komisioni ka dorëzuar pranë Drejtorisë së Spitalit projekt propozimin dhe përshkrimin e materialeve për pajisjen e shtëpizave të mbështetura.

Me Relacionin nr. 88, datë 11.01.2024, drejtuar Drejtores së Spitalit, Dr. L.S në cilësinë e Shefes së Shërbimit Kronik, ka përshkruar konstatimet e incidentit të ndodhur ndaj pacientes I.J, të diskutuara në mbledhjen e Këshillit Tekniko Administrativ në datë 09.01.2024, paciente e cila kishte djegur këmbën dhe ka kërkuar nga titullarja e institucionit që në mungesë të kamerave të sigurisë, ti drejtohet organeve kompetente (Prokurorisë) për të gjetur përgjegjësitë e incidentit me pasoja në shëndetin e pacientes.

Me shkresën nr. 136, datë 16.01.2024, Shefe e Shërbimit Akut, znj. E.Sh dhe Shefe e Shërbimit Kronik znj. L.S, i janë drejtuar me shkresë Drejtores së Spitalit, në të cilën i kanë kërkuar që ti vihen në dispozicion masat e marra për punonjësit që ishin përfshirë në incidentet e relatuar në mbledhjen e Këshillit Tekniko Administrativ të datës 09.01.2024.

Me shkresën nr. 224, datë 25.01.2024, znj. E.Sh dhe znj. L.S kanë ripërsëritur kërkesën drejtuar Drejtores së Spitalit, lidhur me vënien në dispozicion të masave të marra për punonjësit që ishin përfshirë në incidentet e relatuar në mbledhjen e Këshillit Tekniko Administrativ të datës 09.01.2024.

Në Procesverbalin nr. 632, datë 06.03.2024, në mes të tjerash informohet se: *“Sot me datë 05.03.2024, u mbajt mbledhja në lidhje me relacionin e datës 01.03.2024, i hartuar nga mjekët drejtuar drejtorisë së spitalit. Nëpërmjet tij drejtoresha vihet në dijeni nga stafi mjekësor për mënyrën e trajtimit të një pacienti të alkolizuar dhe etikës së përdorur nga Dr. L.S. Dr. Znj. L.S nuk ishte e pranishme në mbledhje duke lajmëruar në telefon Shefen e Personelit se kishte vajzën me temperaturë. Propozohet nga mjekët që për rastin të ndërrmerrej masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna” dhe (znj. L.S) të hiqej nga posti si Shefe Shërbimi Akut”.*

Spitali Psikiatrik Vlorë me shkresën nr. 649, datë 07.03.2024, ka njoftuar ankuesen për marrjen e masës disiplinore *“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”*, me arsyen se Dr. L.S ka shkelur protokollin mjekësor të diagnostikimit dhe mjekimit në Shërbimin e Shëndetit Mendor si dhe shkeljes së etikës profesionale, bazuar në Relacionin nr. 596, datë 01.03.2024 dhe Procesverbalit të mbajtur në Këshillin Tekniko Administrativ Mjekësor me nr. 632, datë 06.03.2024.

Spitali Psikiatrik Vlorë me Urdhrin nr. 103, datë 12.03.2024 *“Për emërim në detyrë”* ka urdhëruar: *“Emërimin e Shefes së Shërbimit Kronik Burra-Gra, znj. L.S në Pavionin Kronik Burra-Gra, me detyrë mjekë psikiatre”.*

Me shkresën nr. 686, datë 12.03.2024 drejtuar Drejtorisë së spitalit, znj. L.S ka kërkuar informacion se përse është liruar nga detyra e Shefes së Shërbimit Kronik Burra-Gra.

Ankuesja nuk ka rënë dakord me masën disiplinore dhe nëpërmjet Kërkesë Padisë datë 19.04.2024, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje, me objekt:

1. *“Konstatimin e pavlefshërisë absolute të aktit administrativ – masë disiplinore nr. 649, datë 07.03.2024, për “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”.*
2. *Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ – Urdhër nr. 101, datë 11.03.2024 për “Lirim nga detyra të Shefes së Shërbimit kronik Burra-Gra, të znj. L.S”.*
3. *Shpërblimin e dëmit jo pasuror (moral) prej 800.000 lekë”.*

Në datë 27.04.2024, znj. L.S ka qenë e ftuar në podkastin *“Fol me Anila Hoxhën” “Administrata paralele”⁸*, të transmetuar në Top Albania Radio, në të cilën ka folur lidhur me procedurën e

⁸ <https://www.youtube.com/watch?v...>, min 29.30 deri 37.00.

parregullt të ndjekur nga Spitali Psikiatrik Vlorë, për dhënien e masës disiplinore *“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”* në datë 07.03.2024, shkarkimin nga pozicionin i shefes së shërbimit dhe kërkesë padinë e ngritur kundër spitalit, lidhur me masën disiplinore.

Me shkresën nr. 1042, datë 29.04.2024, mjekët e Spitalit Psikiatrik Vlorë, Z. S.T, Znj. E.Sh, znj. B.C, znj. D.B, znj. N.V dhe znj. E.T, i janë drejtuar MSHMS, Urdhrit të Mjekut, Avokatit të Popullit, DROSHKSH Vlorë dhe Drejtores së Spitalit Psikiatrik Vlorë, me një kërkesë urgjente, në të cilën në mes të tjerash informojnë se: *“Ne mjekët e Spitalit Psikiatrik Vlorë jemi shumë të indinjuar, të fyer, të shantazhuar dhe të traumatizuar psikologjikisht nga intervista e dhënë në Top Albania Radio nga Dr. L.S. Në këto kushte unanimisht kërkojmë nga ana juaj të shqyrtohet rasti në fjalë me seriozitet dhe të merren masa urgjente mbi aftësinë profesionale, etikën, komunikimin me kolegët dhe eprorët pasi kjo mjeke në mënyrë të përsëritur ka sjellë problematika në Spital dhe pasoja në punë”*.

Spitali Psikiatrik Vlorë me shkresën nr. 1233, datë 27.05.2024, ka njoftuar ankuesen për marrjen e masës disiplinore *“Vërejtje”*, me arsyen se znj. L.S ka shkelur detyrat si mjeke roje duke mosqenë prezent në orarin e punës dhe duke lënë shërbimin pa mbuluar si dhe shkeljes së etikës profesionale, bazuar në Procesverbalin e mbajtur në zyrën e Drejtorit në orën 12.00, me nr. 1225, datë 24.05.2024, lidhur me problematikën ku gjatë paradites Dr. L.S duhet të ishte duke dhënë shërbim në Spitalin Psikiatrik pasi ishte mjeke roje, por mjekja nuk ka qenë në spital, duke bërë që në spital pacientët të prisnin disa orë për të bërë vizitat.

Në Procesverbalin nr. 1228, datë 27.05.2024, përshkruhet incidenti i ndodhur në datë 27.05.2024, midis pacientit R.V dhe personelit të Spitalit z. E.M, kujdestar dhe shoferit z. S.D.

Me Relacionin nr. 1254, datë 29.05.2024, n/drejtori Teknik z. S.T ka informuar Drejtorinë e Spitalit, lidhur me diskutimet e bëra në mbledhjen e datës 28.05.2024, mbi incidentin e ndodhur në datë 27.05.2024, që në përfundim është arritur në konkluzionin që të gjithë duhet të punojnë maksimalisht dhe me rigorozitet në mënyrë që incidente të tilla të mos përsëriten.

MSHMS me shkresën nr. Gr-13/1, datë 27.05.2024, drejtuar DROSHKSH Vlorë dhe Spitalit Psikiatrik Vlorë, ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën e mjekëve të spitalit, ku në mes të tjerash informon se: *“.... Drejtoria e Spitalit Psikiatrik Vlorë, duhet të marrë masa për shqyrtimin e kësaj problematike duke u bazuar në Kodin e Punës, kontratën kolektive, si dhe Udhëzimin nr. 205, datë 09.04.2024 “Për procedurat e punësimit, emërimit, pezullimit, lirimimit dhe të disiplinës të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet platformës elektronike”*.

Pas shqyrtimit të kësaj problematike, për vendimin e marrë të informohet MSHMS dhe Avokati i Popullit si dhe mjekët e Spitalit Vlorë”.

Spitali Psikiatrik Vlorë me Urdhrin nr. 188, datë 30.05.2024, *“Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës”*, bazuar në Rregulloren e Brendshme të Spitalit Psikiatrik me nr. 1304, datë 10.10.2013, në zbatim të neneve 143, 144 dhe 153 të Kodit të Punës, Kontratës Individuale të Punës, neni 11, ju

bëjmë me dije se bazuar në nenin 153, pika 3 ku punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë, të përsëritur,

Urdhëroj:

1. Shkëputjen e marrëdhënieve të punës për shkelje të detyrimeve kontraktuale me faj të rëndë në mënyrë të përsëritur si dhe masave të marra bazuar në Kontratën Individuale neni 11, znj. L.S me detyrë Mjeke Psikiatre në Pavionin Kronik burra-gra.

Nga përmbajtja e këtij Urdhri, rezulton se Spitali Psikiatrik Vlorë, për marrjen e kësaj mase disiplinore, është bazuar tek:

- Relacionit me nr. 596, datë 01.03.2024;
- Procesverbalit me nr. 632, datë 06.03.2024;
- Kërkesës urgjente drejtuar MSHMS me nr. 1042, datë 29.04.2024;
- Procesverbalit me nr. 1228, datë 27.05.2024;
- Procesverbalit nr. 1225, datë 24.05.2024;
- Relacionit me nr. 1254, datë 29.05.2024;
- Shkresën e MSHMS me nr. Gr-13/1, datë 30.05.2024.

Komisioneri vlerëson se, marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet punëmarrësit/ankuesit dhe punëdhënsit/Spitali Psikiatrik Vlorë, i nënshtrohen përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore që normojnë këtë marrëdhënie.

Komisioneri vëren se, një ndër argumentet që Spitali Psikiatrik Vlorë ka përdorur për të justifikuar dhënien e masave disiplinore, uljen në detyrë dhe zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me ankueses ka qenë se, Dr. L.S, ka shkelur protokollin mjekësor dhe të detyrave si mjeke.

Lidhur me pretendimet e palëve dhe argumentimet e tyre për shkeljet e protokolleve mjekësore apo shkelje të tjera për të cilat palët kanë dorëzuar deklarata me shkrim dhe të noterizuara të kundërta sipas palës që i ka dorëzuar, të bëra nga anëtarë të personelit të Spitalit Psikiatrik Vlorë, të mjekëve të tjerë, të pacientëve dhe familjarëve të tyre, Komisioneri vlerëson se nuk disponon ekspertizën e duhur për të vlerësuar shkeljen e këtyre protokolleve mjekësore, por bazuar në kompetencat e ngarkuara nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar do të vlerësojë trajtimin e pafavorshëm gjatë procedurës së ndjekur për dhënien e masave disiplinore dhe kompetencën për institucionin që vlerëson shkeljen e protokolleve mjekësore dhe të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore.

Lidhur me sa më lart, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se ka kërkuar shprehimisht nga Spitali Psikiatrik Vlorë të provonte se si ankuesja kishte konsumuar shkeljet e pretenduara prej tyre, Spitali Psikiatrik Vlorë nuk arriti t’i argumentonte e provonte ato, apo që të kishte ndërmarrë hapa konkretë për denoncimin e ankueses në instancat përkatëse kompetente për të shqyrtuar shkelje të protokollit mjekësor, administrativ apo penal.

Kështu, nëse do të kishte shkelje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore nga ana e mjekut, duke qenë se ankuesja është pjesë e Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, Spitali Psikiatrik Vlorë duhet ta kishte referuar pretendimin për shkeljet etike të mjekes Znj. L.S tek ky institucion.

Ligji nr. 123/2014 “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 5 ka përcaktuar se:

“Asnjë individ nuk mund të ushtrojë profesionin e mjekut, në sistemin e kujdesit shëndetësor publik apo privat në Republikën e Shqipërisë, pa qenë anëtar i Urdhrit të Mjekëve dhe pa qenë i pajisur me licencën për ushtrimin individual të profesionit, të lëshuar nga ky organizëm.

Janë anëtarë të Urdhrit të Mjekëve të gjithë mjekët që ushtrojnë profesionin e mjekut/mjekut specialist në Republikën e Shqipërisë dhe që përmbushin kriteret e përcaktuara në këtë ligj...”.

Në nenin 16 të këtij ligji “Komisionet disiplinore” përcaktohet se:

“1. Pranë këshillave rajonalë dhe Këshillit Kombëtar funksionojnë komisionet disiplinore si organizma të gjykimit profesional. Komisioni disiplinor rajonal përbëhet nga 9 anëtarë të zgjedhur nga Këshilli Rajonal. Komisioni Disiplinor Kombëtar përbëhet nga 15 anëtarë të zgjedhur nga Këshilli Kombëtar.

2. Komisioni shqyrton ankesat e bëra nga çdo person apo institucion në organet e Urdhrit, të cilat lidhen me ushtrimin e profesionit dhe përbëjnë shkelje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore”.

Në nenin 1, të Rregullores për Gjykimin Disiplinor Profesional, të miratuar me Vendimin nr.1, datë 08.04.2016 të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, të ndryshuar, përcaktohet se:

“Gjykimi Disiplinor Profesional dhe Rregullorja e Gjykimit Disiplinor Profesional janë bazuar në ligjin nr. 123/2014 “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”, në Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore dhe në Statutin e UMSH-së.

Mbështetur në këto akte normative, UMSH ndërmerr veprime dhe bën gjykimin disiplinor profesional të anëtarit të vet, në rastet kur: ...e) Veprimet dhe sjellja e tij përbëjnë shkelje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore dhe legjislacionit në fuqi”.

Në nenin 68 të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, përcaktohet se: “Çdo akt mjekësor, apo sjellje profesionale në kundërvajtje me dispozitat e këtij Kodi, përbën objekt për ndjekje dhe gjykim disiplinor profesional bazuar në Ligjin 8615, datë 01.06.2000 “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në Rregulloren e Gjykimit Disiplinor Profesional të Urdhrit të Mjekëve”.

Pra, referuar legjislacionit sipërcituar, Komisioneri vlerëson se organi që ka kompetencën kryesore për vlerësimin profesional dhe etik të mjekëve janë Komisionet Disiplinore të Urdhrit të Mjekëve të Republikës së Shqipërisë.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se, Spitali Psikiatrik Vlorë, në rastin konkret, pretendimet për shkelje të etikës dhe deontologjisë mjekësore nga ana e mjekes Znj. L.S, duhet t'i kishte referuar pranë këtij organi kompetent për shqyrtimin e sjelljeve të mjekëve në kundërshtim me parashikimet e Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore apo akteve të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë marrëdhëniet e mjekëve me pacientët, kolegët, institucionin, etj.

Lidhur me sa më lart, Komisioneri vlerëson se, nëse Spitali Psikiatrik Vlorë kishte pretendime që mjekja Znj. L.S kishte bërë shkelje të protokolleve mjekësore duke vënë në dyshim aftësitë e saj profesionale, kishte të drejtën dhe detyrimin t'i denonconte këto veprime në institucionet kompetente për shqyrtimin dhe vlerësimin e tyre.

Komisioneri gjykon se, Spitali Psikiatrik Vlorë nuk ka arritur të provojë përtej çdo dyshimi, pretendimet e saj se ankuesja ka shkelur protokollin e mjekimit dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore dhe se ka ndjekur një procedurë të rregullt ligjore, bazuar në legjislacionin sipërcituar, lidhur me shkëputjen e marrëdhënieve të punës.

Lidhur me procedurën e ndjekur për dhënien e masave disiplinore dhe zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me ankuesen nga ana e Spitalit Psikiatrik Vlorë, Komisioneri ka analizuar bazën ligjore në të cilën është mbështetur Spitali Psikiatrik Vlorë, kur ka justifikuar dhënien e masave disiplinore dhe ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës me subjektin ankues.

Spitali Psikiatrik Vlorë largimin e ankuses nga puna e ka bazuar tek Kodi i Punës, në nenin 153, pika 3 të tij, e cila ka përcaktuar se: *“Gjykata vendos nëse ekzistojnë shkaqe të justifikuara për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës. Konsiderohen shkaqe të justifikuara rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë, si edhe rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të lehtë, në mënyrë përsëritur, me gjithë paralajmërimin me shkrim të punëdhënësit”*.

Kodi i Punës, si dhe Kontrata Individuale e Punës, e cila në kuptim të përcaktimit të detyrimeve dhe gëzimit të të drejtave ndërmjet palëve kontraktuale ka fuqinë e ligjit, kanë përcaktuar në mënyrë të detajuar rastet se kur mund të zgjidhet në mënyrë të menjëhershme kontrata e punës nga punëdhënësi.

Neni 37, i Kodit të Punës *“Masa disiplinore”*, ka specifikuar se: *“Masat disiplinore parashikohen kryesisht në kontratën kolektive të punës. Në çdo rast kontrata individuale duhet t'i referohet akteve përkatëse, lidhur me masat disiplinore. Procedura e shqyrtimit të masës disiplinore nga punëdhënësi duhet të garantojë të drejtën e punëmarrësit për t'u dëgjuar, mbrojtur, parashtruar fakte dhe prova, brenda një afati të arsyeshëm”*.

Neni 9 të Kontratës së Punës datë 17.04.2007, të lidhur mes ankuesit dhe Spitalit Psikiatrik Vlorë, është përcaktuar se: *“Punëdhënësi, në zbatim të nenit 153 të Kodit të Punës, mund të zgjidhë në çdo kohë e menjëherë kontratën e punës kur ka shkaqe të arsyeshme. Do të konsiderohen si shkaqe të arsyeshme në ngarkim të punëmarrësit, rastet kur ai vepron me faj e konkretisht thyen disiplinën*

në punë në mënyrë të përsëritur me gjithë paralajmërimet, vjen me vonesë, largohet para orarit, nuk shfrytëzon kohën e punës”.

Në kontratën e punës dhe në Rregulloren e Brendshme të Spitalit psikiatrik Vlorë, të miratuar me Urdhrin nr. 11, datë 10.10.2013, nuk ka të parashikuara se kush quhen shkelje disiplinore dhe masat disiplinore.

Lidhur me argumentet e dhëna nga Spitali Psikiatrik Vlorë, për dhënien e masave disiplinore dhe zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me ankuesen, Komisioneri vlerëson se nuk qëndrojnë, dhe se, referimi tek baza ligjore e cituar në vendimin për largimin e saj nga puna, është i gabuar dhe i keqzbatuar në këtë rast, për arsyt poshtëcituar:

- Në aktet e mësipërme që normojnë marrëdhënien juridike të punës mes ankuesit dhe punëdhënësit, nuk është e parashikuar dhe e përcaktuar se cilat janë rastet konkrete që duhen konsideruar si “shkelje të rënda”.
- Pavarësisht këtij fakti, bazuar në përcaktimet e nenit 9, të Kontratës të Punës, Komisioneri konstaton se, rasti i pretenduar nga Spitali Psikiatrik Vlorë kundrejt ankueses, nuk përfshihet në asnjë nga rastet e parashikura në këtë Kontratë, që sipas përcaktimit të saj të mund të quhej shkelje disiplinore, mbi bazën e të cilës, më pas mund të ndërmerreshin masat disiplinore dhe zgjidhja e marrëdhënieve të punës.

Bazuar në dispozitat e Kodit të Punës parashikohet se punëdhënësi nuk mund të zgjidhë kontratën e punës pa dhënë më parë arsytet me shkrim për zgjidhjen e kontratës. Referuar nenit 144/3, të Kodit të Punës, arsytet për të cilat një punëdhënës mund të zgjidhë kontratën e punës duhet të jenë të lidhura me shkaqe të tilla si aftësia, sjellja e punëmarrësit ose kërkesat operacionale të ndërmarrjes.

Në momentin që punëdhënësi vendos të ndërpresë marrëdhënien e punësimit me punëmarrësit ai duhet ta bëjë atë konform një procedure të përcaktuar dhe të parashikuar nga neni 144, të Kodit të Punës, ku parashikohet se: “1. Pas kohës së marrjes në provë, kur punëdhënësi mendon të zgjidhë kontratën e punës, ai duhet të njoftojë me shkrim punëmarrësin të paktën 72 orë para takimit dhe të bisedojë me të. 2. Punëdhënësi, gjatë kësaj bisede, i parashtron punëmarrësit arsytet e vendimit të parashikuar për t’u marrë dhe i jep atij mundësi për t’u shprehur. 3. Zgjidhja njoftohet me shkrim, brenda një afati nga 48 orë deri në një javë pas takimit. Në njoftimin me shkrim, punëdhënësi përcakton arsytet e zgjidhjes së kontratës, të cilat lidhen me shkaqe të tilla si aftësia, sjellja e punëmarrësit ose kërkesat operacionale të ndërmarrjes...”.

Procedura e parashikuar për zgjidhjen e kontratës së punës, sipas nenit 144, të Kodit të Punës, ka qëllim që të mbrojë punëmarrësin. Takimi midis punëdhënësit dhe punëmarrësit i jep mundësinë këtij të fundit që të shprehet, të japë mendimin e tij dhe të mbrohet. Periudha prej 72 orësh e njoftimit përpara takimit i jep mundësi punëmarrësit për të përgatitur argumentet e tij. Kjo procedurë nuk duhet të jetë kurrësi fiktive, por duhet ti parashtronen punëmarrësit shkaqet konkrete pse kërkohet të largohet nga puna dhe t’i jepet mundësia që pasi të jetë njohur, të shprehet në lidhje me to, të mbrohet dhe të dëgjohet.

Gjykata Kushtetuese, në Vendimin nr. 69, datë 16.10.2000, ka mbajtur qëndrimin se: *“Parimi i kontradiktoritetit lidhet e me të drejtën e palëve për t’u dëgjuar, për t’i bërë të njohur njëra tjetrës mjetet dhe faktet mbi të cilat i mbështesin të gjitha pretendimet e tyre, provat e grumbulluara, referencën e saktë ligjore”*.

Gjatë shqyrtimit të ankesës Spitali Psikiatrik Vlorë nuk arriti të provojë se kishte respektuar procedurën për dhënien e masave disiplinore dhe për zgjidhjen e kontratës së punës sipas nenit 144 të Kodit të Punës.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se Spitali Psikiatrik Vlorë nuk e ka njoftuar paraprakisht ankuesen për dhënien e masave disiplinore dhe zgjidhjen e kontratës dhe as ka realizuar takim me të, për t’i komunikuar arsyet e dhënies së masave disiplinore dhe zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, duke mos i dhënë mundësinë të shprehet mbi këto arsye.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ankuesja është cënuar në të drejtën e saj për një proces të rregullt, pasi ajo nuk ka patur mundësi që në mënyrë efektive të ushtronte të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur në lidhje me arsyet e dhënies së masave disiplinore dhe zgjidhjes së marrëdhënieve të punës.

Në këto kushte provohet se ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, dhe se masa e marrë për largimin e saj nga puna është bërë në shkelje të plotë të procedurës ligjore që duhet ndjekur për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Në përfundim, bazuar në analizimin e veprimeve të Spitalit Psikiatrik Vlorë kundrejt mjekes Znj. L.S, bazës ligjore tek e cila janë referuar masat kundrejt saj, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues, është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Spitalit Psikiatrik Vlorë, pasi shkelja e protokolleve të mjekimit nga ana e ankueses nuk është vlerësuar nga Komisioni disiplinor i DROSHKSH Vlorë dhe Urdhri i Mjekëve dhe është në shkelje të plotë të procedurës dhe afateve të parashikuara nga Kodi i Punës.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2⁹, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ky ligj, ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

⁹“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim”.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Gjatë parashtrimeve subjekti ankues ka pretenduar diskriminim për “çdo shkak tjetër”, duke argumentuar se trajtimi i padrejtë e i pafavorshëm ndaj saj ka qënë për shkak se:

1. Znj. L.S në datë 10.01.2024, nuk pranoi të firmosë një dokument, në të cilin ishin listuar pajisjet dhe orenditë e shtëpizave të mbrojtura si edhe çmimet përkatëse.
2. Znj. L.S kishte krijuar pakënaqësi tek Drejtorja e institucionin për shkak se ndërgjegjja e saj nuk ja lejonte të injorojë parregullsitë, duke drejtuar ankesa/kërkesa në institucion, si: Relacion nr. 88, datë 11.01.2024, ku znj. L.S ka identifikuar përgjegjësit për djegien e këmbës së pacientes I.J dhe i ka kërkuar znj. M.M ti drejtohet organeve të zbatimit të ligjit për të hetuar rastin; Me shkresën nr. 136, datë 16.01.2024 dhe nr. 224, datë 26.01.2024, i ka kërkuar znj. M.M informacion mbi masat disiplinore të marra ndaj punonjësve në lidhje me incidentin e djegies së pacientit.
3. Vitin e kaluar janë përdorur materialet (ankesat) e znj. L.S në lidhje me parregullsitë e Spitalit Psikiatrik Vlorë në emisionin investigativ “Piranja¹⁰”, nga ku rezultoi edhe me largimin e ish-drejtores.
4. Për shkak se në datë 27.04.2024, ankuesja ka dhënë intervistë në podkastin “Fol me Anila Hoxhën” “Administrata paralele”¹¹, të transmetuar në Top Albania Radio, në të cilën ka folur lidhur me procedurën e parregullt të ndjekur nga Spitali Psikiatrik Vlorë për dhënien e masës disiplinore dhe shkarkimin nga pozicionin i shefes së shërbimit dhe kërkesë padinë e ngritur kundër spitalit, lidhur me masën disiplinore.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh¹². Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohej mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut

¹⁰ <https://www.syri.net/politike/628832/video/>
<https://www.youtube.com/watch?v=>

¹¹ <https://www.youtube.com/watch?v=>, min 29.30 deri 37.00.

¹² Neni 1, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

(KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh¹³.

Krahas praktikës kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bëjnë të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

GJEDNJ-ja ka zhvilluar disa shkaqe në kategorinë “statuse të tjera”. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një karakteristikë personale të identifikueshme, personale, ose “status”, me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri¹⁴. Gjykata ka theksuar se fjalës “shkak/status tjetër” në përgjithësi i është dhënë një kuptim i gjerë¹⁵. Interpretimi i këtij nocioni “*nuk është kufizuar në karakteristika që janë personale në kuptimin që ato janë të lindura apo të pandashme*”¹⁶.

Disa karakteristika që GJEDNJ-ja ka njohur se mbrohen në kuadër të “statuseve të tjera” janë: Në Engel dhe të tjerët kundër Vendeve të Ulta, Gjykata vendosi që një dallim i bazuar në gradën ushtarake mund të binte në kundërshtim me nenin 14; në Larkos kundër Qipros, Gjykata gjeti shkelje të nenit 14 si rezultat i një dallimi midis qiramarrësve të shtetit nga njëra anë dhe qiramarrësve të pronarëve privatë nga ana tjetër; në Shelley kundër Mbretërisë së Bashkuar, Gjykata konsideroi se të qenit i burgosur mund të binte në nocionin e “statusit tjetër” sipas nenit 14; në Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë, Gjykata nuk adresoi në mënyrë specifike çështjen e “statusit tjetër”, por në gjetjen e një shkelje të nenit 14 dhe nenit 8 pranoi se statusi si ish oficer i KGB-së përfshihet në nenin 14; në Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar, Gjykata gjeti shkelje të

¹³ Neni 14, i KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

¹⁴ Shih: Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar, prg 55; Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës, prg 56; Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, prg 61 dhe 70; Novruk dhe të tjerët kundër Rusisë, prg. 90.

¹⁵ Shiko: Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, prg 70.

¹⁶ Shiko: Biao kundër Danimarkës, aplikimi nr. 38590/10, prg.89.

nenit 14 si rezultat i dallimit që bëhej nga skema e liritë të parakohshëm bazuar në kohëzgjatjen e dënimit me burg.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: *“Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”*.

Lidhur me pretendimin e ankueses se nuk pranoi të firmoste dokumentin për arredimin e shtëpizave të mbrojtura, Komisioneri vlerëson se bazuar në informacionin dhe aktet e administruara gjatë procedurës hetimore, rezulton se ky pretendim i znj. L.S është i karakterit deklarativ dhe nuk mbështetet në prova konkrete¹⁷. Për këtë arsye, Komisioneri vlerëson se pretendimet e ankueses kundër Spitalit Psikiatrik Vlorë, për shkak të mosfirmosjes së dokumentit, nuk mund të provohen dhe nuk do bëhet objekt shqyrtimi në vijim të trajtimit të ankesës.

Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankueses se shkak për trajtimin e saj të padrejtë e të pafavorshëm është bërë për arsye të ankesave/kërkesave drejtuar Spitalit dhe për shkak të denoncimeve mediatike të gjendjes dhe parregullsive në Spital Psikiatrik Vlorë të bëra në emisionin investigativ *“Piranjë”* dhe në podkastin *“Fol me Anila Hoxhën”* të transmetuar në Top Albania Radio, qëndron dhe është i provuar, bazuar në provat e depozituara në dosje.

Në këtë kontekst, bazuar në deklaratimet, faktet e provat e sjella nga palët, Komisioneri vlerëson si shkaqe të mbrojtura nga LMD, referuar si *“çdo shkak tjetër”*¹⁸.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive për trajtimin ndryshe të evidentuar. Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me shkaqet e mbrojtura, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

¹⁷ Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi ligjor i ankueses ka deklaruar se: *“min 45. Nuk e vërtetojmë dot kërkesën për nënshkrimin e dokumentit me çmime për projektin e shtëpizave, pasi është bisedë që është zhvilluar mes tyre “tete-a-tete”*”.

¹⁸ Për analogji citojmë: Vendimin nr. 151, datë 28.10.2020, Vendimin nr. 151, datë 11.08.2021, Vendimin nr. 170, datë 28.08.2023 dhe nr. 302, datë 05.12.2024, të KMD-së.

Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit “*Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional*”.

Doktrina kushtetuese, e trajton të drejtën e individit për punë, duke theksuar se liria për punë mbrohet nga rregullimet kushtetuese.¹⁹

Gjykata Kushtetuese²⁰, ka mbajtur qëndrimin se: “*E drejta për punë, që garanton neni 49/1 i Kushtetutës, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit profesional me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetuese, përbën një të drejtë të individit në kuptimin, që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës.*

Kjo e drejtë e individit për të përfutur me punë të ligjshme fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi.

E drejta për punë dhe liria e profesionit nënkuptojnë të drejtën e individit për të ushtruar çdo veprimtari të ligjshme që i sjell të ardhura dhe që nuk ka afat të përcaktuar, me përjashtim të rregullimeve të veçanta ligjore. Në këtë kuptim, veprimi i organeve shtetërore që sjell pasoja të drejtpërdrejta në pengimin e veprimtarisë profesionale përbën cenim të kësaj lirie veprimi. Garancia që Kushtetuta i jep individit lidhur me të drejtën për punë dhe lirinë e profesionit ka si qëllim mbrojtjen e këtyre nga kufizimet e papërligjura të shtetit.

Liria e profesionit nuk është thjesht një e drejtë për të pasur një vend pune. Ajo nuk duhet kuptuar vetëm si e drejtë sociale, por dhe si liri negative që nuk lejon ndërhyrjen ose pengimin e shtetit gjatë ushtrimit të saj. Përcaktimi që neni 49 i Kushtetutës i bën të drejtës për punë duhet të merret në kuptim të dyfishtë. Ajo përbën një detyrim pozitiv që kërkon angazhimin shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e një të drejte të tillë, por edhe detyrim negativ, i cili kërkon mosndërhyrjen e shtetit për të cenuar këtë të drejtë”.

Në rastin në fjalë kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune midis shtetit dhe individit, e cila rregullohet nga Kodi i Punës.

Parimi i mosdiskriminimit, përshkon në frymë dhe në nene këtë akt rregullator, i cili në pikën 1, të nenit 9, të tij ka përcaktuar se: “*Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi*”.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ-ja) si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, “*E drejta për respektimin e jetës*

¹⁹ Livio Paladini, “Diritto Costituzionale”, CEDAM, Padova, 1991, fq. 166-175.

²⁰ Vendimi nr. 20, datë 11.07.2006, i GJK.

private dhe familjare”. Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë shoqëruese shkaqesh.

Ndërkohë Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar:

- a. “në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;
- b. në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;
- c. nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;
- d. nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejte parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

“Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore²¹”, i cili sanksionon të drejtën për punë në nenin 6, të tij. Sipas këtij akti ndërkombëtar në fushën e të drejtave të njeriut, i cili është ratifikuar nga vendi ynë, parashikohet se, e drejta për punë përfshin të drejtën e secilit për të pasur mundësinë e sigurimit të jetesës, duke punuar punën e pranuar lirisht dhe marrjen e masave të përshtatshme për ta mbrojtur këtë të drejtë. Sipas nenit 2/2, të Paktit, të drejtat e parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim.

Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës²² “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi.

Konventa e përkufizon diskriminimin si - *çdo dallim tjetër*, përjashtim ose preferencë që çon në prishjen apo shtrembërimin e barazisë, të mundësisë ose trajtimit në drejtim të punësimit ose të profesionit.

Karta Sociale Europiane²³ në nenin 1, pika 2, parashikon: “ Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për punë, Palët angazhohen... ..2 të mbrojnë efektivisht të drejtën e punëtorit për të fituar jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht... ” Ky parashikim, është interpretuar vazhdimisht nga Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale (KEDS) si vendosje e një të drejte për të mos u diskriminuar në punësim²⁴.

²¹ Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991

²² Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

²³ Ratifikuar me ligjin nr. 8960, date 24.10.2002.

²⁴ Shih: *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë*, prg 30.

Garancitë për mbrojtjen nga diskriminimi parashikohen në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane, ku përcaktohet shprehimisht mbrojtja nga diskriminimi për cilindo nga shkaqet e mbrojtura.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimin, parime të cilat janë të ndërthurura ngushtë.

Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata të jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë, konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme²⁵.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si, çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është *diskriminimi i drejtpërdrejtë*, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji*. Bazuar në nenin 9/1, të Kodit të Punës, ndalohet çdo formë diskriminimi në ushtrimin e të drejtës për punësim dhe profesion, sipas parashikimeve të bëra në Kod dhe ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.

Në bazë të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në nenin 6, të tij, përcaktohet se: “*Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi*”.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës. Parimi i

²⁵ Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.

zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS²⁶ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm. Bazuar në nenin 82/2 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenin 9/10 të Kodit të Punës, barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm.

Bazuar në nenin 9, pika 10, të Kodit të Punës, parashikohet se: *“10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”*.

Bazuar në nenin 82, pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të padrejtë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse Spitali Psikiatrik Vlorë, që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.

Nëse punëdhënësi/Spitali Psikiatrik Vlorë, që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.²⁷

Parimi i zhvendosjes së barrës së provës, në çështjet e diskriminimit është i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës - *praesumptio iuris tantum* dhe po kështu bazohet tek logjika e përdorur për vendosjen e lidhjes mes fakteve që tregojnë trajtim të

²⁶ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

²⁷ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

mundshëm diskriminues dhe ekzistencës së këtij trajtimi në realitet. Barra e provës zhvendoset dhe pala kundër të cilës është paraqitur ankesa, për të vërtetuar se nuk ka patur diskriminim, duhet të rrëzojë supozimin faktik se ka patur diskriminim.

Sipas praktikës gjyqësore të vendosur nga GJEDNJ, prova, mund të rrjedhë nga bashkë ekzistenca e konkluzioneve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme ose e supozimeve të ngjashme të faktit të pakundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes së nevojshme për të arritur një përfundim të caktuar dhe, në lidhje me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura thelbësisht me specifikën e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe të drejtën e pretenduar²⁸.

Në aspektin procedural, si fillim duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkaku i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër.

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është bazuar pikërisht në standartin e mësipërm të të provuarit, gjatë shqyrtimit dhe konkluzioneve të arritura, në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Bazuar në analizën e mësipërme rezultoi se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nga ana e punëdhënësit/Spitali Psikiatrik Vlorë përse i takon masave disiplinore, uljes në detyrë dhe zgjidhjes së marrëdhënieve të punës.

Njëkohësisht, sa më sipër, rezulton e pranuar nga punëdhënësi/ Spitali Psikiatrik Vlorë, se shkak për largimin e ankueses nga puna, është bërë shkelja e protokolleve mjekësore dhe qëndrimi i saj kritik kundrejt gjendjes dhe kushteve të Spitalit, duke i konsideruar deklaratat e ankueses si presion te drejtuesi dhe te stafi (*duke i cituar aktet (nr. 1042, datë 29.04.2024 dhe shkresa MSHMS nr. Gr-13/1, datë 30.05.2024) edhe si motivacion, në urdhrin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës*).

Me shkresën nr. 2377, datë 17.10.2024, Spitali Psikiatrik Vlorë në mes të tjerash ka informuar se: “fq. 6; *Shantazhi është një metodë e njohur për mjeken në fjalë, pasi edhe në videot e nxjerra prej saj në emisionin “Piranjat”, ajo nuk është përpjekur si mjeke të ofrojë zgjidhje, por ka përdorur informacionin e marrë gjatë ushtrimit të detyrës për të ushtruar presion te drejtuesi i institucionit dhe te stafi*”.

Gjithashtu në Procesverbalin nr. 1047, datë 30.04.2024, të mbajtur në mbledhjen me Drejtorin e DROSHKSH Vlorë, Drejtorin e Spitalit Psikiatrik dhe stafit mjekësor të spitalit, në mes të tjerash është shprehur se: “*Drejtoresha: Tematika e mbledhjes sot lidhet më çështjen e Dr. L.S në lidhje me pretendimet, diskutimet e bëra publike për shërbimin spitalor. Sot jemi këtu për të përcaktuar*

²⁸ GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (GC) paragrafi 147, (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, *Timishev kundër Rusisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

edhe pikat mbi “i”, se ku çalon puna që ne nuk arrijmë të bashkëpunojmë dhe të ofrojmë një shërbim cilësor siç pretendohet ndryshe dhe lidhur me një relacion që ka ardhur në drejtori nga mjekët dhe n/drejtori/Teknik, si dhe në lidhje me një dalje mediatike që doktoresha ka kundër spitalit”; Drejtori i DROSHKSH z. L.R: “.....Dua të dëgjoj kërkesat dhe ankesat që ti ke (Znj. L.S) dhe i bën për kolegët dhe drejtuesin e spitalit dhe më tepër më shqetëson fakti që ti del në media dhe shpreh këtë pakënaqësi që ke”.

Bazuar në deklaratimet e qëndrimin e punëdhënësit, gjatë procedurës hetimore, Komisioneri vlerëson se ankuesja e mbart shkaku e sipërpërmendur.

Nga ana e punëdhënësit nuk u sollën prova dhe argumenta bindës që të mund të provonin apo përligjinin faktin se shkelja e protokolleve të mjekimit nga ana e ankueses të ishte vlerësuar nga Komisioni disiplinor i DROSHKSH Vlorë dhe Urdhri i Mjekëve, apo se procedura e ndjekur për dhënien e masave disiplinore dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës, ishte bërë në respektim të kuadrit ligjor në fuqi, i cili rregullon marrëdhëniet e punës punëdhënës-punëmarrës.

Në këtë kontekst, subjektit ankues, nga ana e Spitalit Psikiatrik Vlorë, duhet t’i ishin siguruar të gjitha garancitë ligjore të parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi, në mënyrë që ajo si punëmarrëse të kishte mundësi reale për t’u mbrojtur efektivisht, me qëllim që shkeljet e evidentuara nga ana e punëdhënësit në shkresën e njoftimit të largimit nga detyra, të mund të shqyrtoheshin në respektim të plotë të procedurës disiplinore.

Lidhur me sa më sipër, si dhe në analizë të rastit konkret, Komisioneri gjykon se, procedura e ndjekur nga punëdhënësi për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me ankuesen, është haptazi jo e ligjshme si dhe në kundërshtim me të drejtat e saj ligjore, normuar nga legjislacioni për marrëdhëniet e punësimit.

Për trajtimin diskriminues në pjesën dërrmuese të çështjeve nuk ekzistojnë prova të drejtpërdrejta.

Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte do të konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, punëdhënësi nuk arriti të provojë me dokumentacion apo prova të tjera që ankuesja nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, lidhur me procedurën e ndjekur për dhënien e masave disiplinore dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

Pra në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se, punëdhënësi nuk ka provuar se:

- Ankuesja është njoftuar për takim dhe t’i ishte komunikuar dhe bërë e ditur shkelja e pretenduar;
- I është drejtuar Komisioni disiplinor të DROSHKSH Vlorë dhe Urdhrit të Mjekëve për shkeljen e protokolleve mjekësore dhe Kodit të Etikës dhe Deontologjinë Mjekësore.

- Që asaj t'i ishte krijuar mundësia për t'u njohur me aktet e provat kundër saj, të cilat provonin sipas punëdhënësit shkeljen e protokolleve mjekësore dhe shkeljen e Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore;
- Ankueses i janë ofruar dhe garantuar mundësi reale për t'u mbrojtur efektivisht nga masa ekstreme e dhënë kundrejt saj, duke i zgjidhur marrëdhëniet e punës në mënyrë të menjëhershme.
- Ka respektuar parimin e kontradiktorialitetit, si pjesë thelbësore e procedurës kontestimore.
- Qëndrimet kritike të ankueses të shprehura dhe në media, nuk kanë ndikuar në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.
- Masa e marrë për lirim të saj nga detyra është e arsyetuar, proporcionale, e drejtë, dhe e bazuar në fakte, prova e ligj.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se, shkelja e procedurës për largimin e ankueses nga detyra, ka cënuar rëndë të drejtat e tij si punëmarrës për një proces të rregullt, të drejtë e ligjor.

Punëdhënësi nuk ka depozituar asnjë provë që të vërtetojë se ndaj ankueses është zbatuar procedura ligjore lidhur me njoftimin e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës/largimin nga detyra, të drejtën për t'u njohur me pretendimet e provat e depozituara kundër saj, për t'u dëgjuar, mbrojtur e paraqitur prapësimet e provat në mbrojtje të vetes.

Organi vendimmarrës në respektim të parimit të kontradiktorialitetit, ka detyrimin që para se të japë vendimin, çdonjëri nga palët t'i japë mundësinë për të paraqitur mendimin lidhur me çështjen mbi të cilën duhet vendosur, si dhe për t'u deklaruar lidhur me pretendimet e palës kundërshtare. Bazuar mbi këtë parim sigurohet barazia e palëve në procesin e iniciuar para organit vendimmarrës dhe mbledhja e fakteve relevante për vendosje meritorie, por edhe konstatimi se çfarë është kontestuese e jokontestuese mes palëve.

Barazia e dy palëve me interesa të kundërta ndikon që secilës palë t'i njihet e drejta që të shprehet në lidhje me veprimet proceduriale, të cilat kryhen nga pala kundër së cilës është ankuar. Duke i vënë në pozita të barabarta, ligji krijon njëkohësisht parakusht për gjykim objektiv.

Pikërisht për këtë shkak, shkelja e parimit të kontradiktorialitetit është paraparë si shkelje esenciale e dispozitave të procedurës kontestimore. Praktika e GJEDNJ-së ka vendosur standarde për krijimin e mundësisë të secilës palë, për t'u mbrojtur efektivisht në të drejtën që pretendon se i është shkelur.

Nga ana tjetër, Komisioneri konstaton se, nga analizimi i fakteve në tërësinë e tyre; pasojat negative subjektivit ankues nga ana e punëdhënësit i kanë ardhur për shkak të ankesave/kërkesave drejtuar Spitalit dhe për shkak të denoncimeve mediatike të gjendjes dhe parregullsive në Spital Psikiatrik Vlorë apo kundrejt vetë titullarit të Spitalit Psikiatrik Vlorë, duke i konsideruar ato si shkelje të detyrimeve kontraktuale.

Ky fakt jo vetëm është pranuar nga punëdhënësi, por i ka shërbyer atij edhe si arsye për të justifikuar zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me të.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri, gjykon se, veprimet e punëdhënësit (ndërprerja e marrëdhënieve të punës) haptazi kanë qenë të motivuara pikërisht nga ankesat/kërkesat drejtuar Spitalit dhe si shkak i deklarimeve dhe qëndrimeve publike të mbajtura prej saj dhe se asaj i është cënuar një e drejtë themelore kushtetuese, siç është e drejta për punë dhe e ushtrimit të detyrës.

Puna është një veprimtari jetike e individëve të aftë për punë. Ajo është burimi i të ardhurave që ata sigurojnë mjetet e jetesës. Gjithashtu, marrëdhënia e punës (*punësimi*) është, përveç të tjerash, një marrëdhënie sociale dhe shoqërore.

Punëdhënësi ka detyrimin të respektojë dhe të mbrojë në raportet e punës personalitetin e punëmarrësve, si dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar sigurinë, mbrojtjen e shëndetit mendor dhe fizik të tyre, si dhe trajtimin me dinjitet të tij.

E drejta për punë buron nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Në kushtet kur ndalimi i diskriminimit është një e drejtë kushtetuese, e detyrueshme për t'u zbatuar drejtpërsëdrejti nga institucionet, është një e drejtë e sanksionuar dhe e mbrojtur shprehimisht me ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, është e natyrshme që kjo e drejtë vendos detyrime negative mbi çdo punëdhënës që krijon, ndryshon apo i jep fund marrëdhënies së punës, të ndërmarrë veprime në përputhje me të drejtën e punëmarrësve për mbrojtjen nga diskriminimi.

Në përfundim të analizimit të çështjes në tërësi, Komisioneri konstaton se, trajtimi i padrejtë, i pabarabartë i ankueses, nuk ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri vlerëson se punëdhënësi/Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë, ka diskriminuar subjektin ankues në të drejtën për punësim, pasi largimi i saj nga puna, është marrë në kundërshtim flagrant të procedurës përkatëse për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, në shkelje të garancive ligjore të znj. L.S, për një proces të rregullt e të drejtë ligjor, si dhe është motivuar për shkak të ankesave/kërkesave drejtuar Spitalit dhe për shkak të denoncimeve mediatike të gjendjes dhe parregullsive në Spital Psikiatrik Vlorë apo titullarit të institucionit.

Për rrjedhojë punëdhënësi, ka shkelur dispozitat e ligjit "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, respektivisht: nenin 3, pikat 1 dhe 2, dhe nenin 12, pika 1, shkronja c, të tij.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, përcaktohet se: "*Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre*".

LMD, në dispozitën e mësipërme, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit.

Ky ligj, përmes nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri, në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar si pasojë e largimit nga puna të ankueses, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur, duke e rikthyer ankuesen në vendin e mëparshëm të punës.

Marrëdhëniet e punës midis ankuesit dhe punëdhënësit rregullohen nga Kodi i Punës. Në nenin 9, pika 9, të Kodit të Punës sanksionohet: *“9. Në rastin kur një person pretendon se është cënuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, sipas këtij Kodi, ndiqet procedura e ankimit, e përcaktuar në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”*.

Ligji i posaçëm që rregullon mbrojtjen nga diskriminimi është ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar. Ky ligj në pjesën e procedurave të shqyrtimit të ankesave para Komisionerit ka përcaktuar vetëm kriteret mbi bazën e të cilave, Komisioneri duhet të vendosë masën e duhur për rregullimin e situatës së konstatuar si diskriminuese, duke e lënë në diskrecionin e Komisionerit të vendosë se cila është masa e duhur për të siguruar mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personit i cili është konstatuar se është diskriminuar. Ndërsa në nenin 38 të tij, që rregullon procedurat e gjykimit të padisë për diskriminim përpara gjykatës, ligji përcakton se: *“Dëmshpërblimi përfshin, ndër të tjera, ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe të pasojave të tyre përmes kthimit në gjendjen e mëparshme, kompensimin e duhur për dëmet pasurore si dhe jopasurore, ose përmes masave të tjera të përshtatshme”*.

Nëpërmjet këtij parashikimi ligji është kujdesur të përcaktojë se, në rastet kur konstatohet se ndërprerja e marrëdhënieve të punës ka ndodhur si pasojë e diskriminimit, një nga mënyrat e dëmshpërblimit është rikthimi i punonjësit në gjendjen e mëparshme. Komisioneri çmon se, rikthimi në gjendjen e mëparshme realizohet duke e rivendosur marrëdhënien e punësimit të ndërprerë për shkak të diskriminimit.

Neni 9, i Kodit të Punës është miratuar me ligjin nr. 136, datë 5.12.2015, me synimin ndër të tjera, harmonizimin e Kodit me direktivat e Bashkimit Evropian për mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e punësimit, por edhe harmonizimin me legjislacionin e posaçëm kombëtar për mbrojtjen nga diskriminimi, që në rastin konkret është ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.

Kodi i Punës, në mënyrë të shprehur referon në dispozitat e ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si ligji i posaçëm që rregullon mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, nëpërmjet parashikimit në nenin 38 të tij, se dëmshpërblimi për diskriminimin përfshin ndër të tjera edhe rikthimin në gjendjen e mëparshme, njeh të drejtën e personit që konstatohet se është larguar për shkaqe diskriminuese, që të rikthehet në vendin e mëparshëm të punës.

Mbrojtja nga diskriminimi e garantuar nga ligji nuk do të ishte efektive nëse punëdhënësi nuk detyrohet të rivendosë marrëdhënien e punësimit, pasi me kushtin që të paguajë dëmshpërblimin për zgjidhje të marrëdhënies së punës në mënyrë të padrejtë, sipas parashikimeve përkatëse të Kodit të Punës, ai mund të largojë çdo punonjës bazuar në një shkak të mbrojtur nga legjislacioni.

LMD, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij, duke sanksionuar se: *“Kur vendos masën, Komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”*.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar si pasojë e largimit të ankuses nga detyra, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur duke rikthyer atë në vendin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenet 32 dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit, të ankuses Znj. L.S, në të drejtën për punësim, për shkak të ankesave/kërkesave drejtuar Spitalit dhe për shkak të denoncimeve mediatike të gjendjes dhe parregullsive në Spital Psikiatrik Vlorë, nga ana e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë.
2. Në referim të pikës 1, Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA